



# **BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR**

NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

2013





**Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor  
në Programin Buxhetor Afatmesëm  
të Republikës së Shqipërisë**



**2013**

Udhëzuesi për zbatimin e VKM-së nr. 465, datë 18 korrik 2012 është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) në kuadrin e Programit Rajonal për Promovimin e Politikave të Përgjigjshme Gjinore në Evropën Juglindore, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

Ky udhëzues është një tjetër produkt si rezultat i bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore dhe UN Women në kuadër të Programit të Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.

Do të dëshironim të falënderojmë të gjithë kontribuesit për mbledhjen e të dhënave dhe njohuritë e tyre teknike në hartimin e këtij udhëzuesi veçanërisht znj. Filloreta Kodra, ish-Zëvendës ministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave, të cilat me kontributin e tyre të veçantë bënë të mundur fillimin e zbatimit të nismës për zbatimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në Shqipëri. Gjithashtu, do të dëshironim të falënderojmë, znj. Kesjana Halili dhe znj. Xhoana Agolli pranë Ministrisë së Financave; znj. Alida Tota, znj. Denada Dibra, znj. Elida Erebara, znj. Brunilda Dervishaj, znj. Etleva Sheshi dhe znj. Etleva Zeqo, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; znj. Tatjana Dishnica, z. Fahri Isaj, znj. Beatrice Bezhani, znj. Entela Kola, dhe znj. Eriola Furxhiu pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; znj. Sheila Quinn, znj. Eneida Hoxha, znj. Rajmonda Duka, dhe znj. Ani Plaku, ekspertë pranë UN Women; znj. Ermira Lubani dhe z. Rezart Xhelo, pranë UN Women.



Austrian  
Development Cooperation



*Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë udhëzues nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionet dhe pikëpamjet e UN Women apo të Kombeve të Bashkuara.*

Vendim nr. 465, datë 18.07.2012 i Këshillit të Ministrave

Udhëzimi nr. 21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”

Udhëzues - Aneksi nr. 1 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 21, dt 21.06.2013 i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Republika e Shqipërisë

BUXHETIM

BUXHETIM GJINOR

BUXHETIM GJINOR

## Tabela e Përmbajtjes

<b>Hyrje.....</b>	<b>6</b>
Prirja globale drejt reformës buxhetore .....	6
Reforma administrative në Shqipëri .....	7
Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, si element i reformës buxhetore .....	8
<b>Informacion i përgjithshëm për Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 465, datë 18.07.2012 .....</b>	<b>10</b>
Vendim nr. 465 i Këshillit të Ministrave.....	12
Udhëzimi nr. 21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm” .....	14
<b>Udhëzuesi .....</b>	<b>18</b>
Qëllimi i këtij Udhëzuesi.....	18
<b>Si ta kuptojmë Vendimin e Këshillit të Ministrave.....</b>	<b>20</b>
Baza ligjore .....	21
Dispozitat e Vendimit .....	21
<b>Përse duhet përfshirë aspekti gjinor në buxhet? .....</b>	<b>22</b>
Hendeku mes politikave dhe buxhetit.....	23
Integrimi i çështjeve gjinore – përshpejtimi i barazisë gjinore.....	23
Përkufizimi i integritit të aspektit gjinor.....	24
Përkatësia gjinore dhe ekonomia.....	24
Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor – përshpejtimi i barazisë gjinore përmes buxhetit.....	25
Kapërcimi i këtij hendeku.....	26
Përkufizimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor .....	26
<b>Kërkesa 1 e VKM-së - Përcaktimi i objektivave gjinorë në programet buxhetore .....</b>	<b>28</b>
Hyrje.....	29
Përgatitja e një metodike .....	29

Integrimi i perspektivës gjinore në procesin e PBA-së.....	30
Struktura dhe proceset e PBA-së.....	30
Instrumentet e Sekretariatit të Bashkësisë së Shteteve.....	38
<b>Kërkesa 3 e VKM-së - Përcaktimi i treguesve të matshëm gjinorë për objektivat dhe produktet e secilit program, në ministritë e linjës.....</b>	<b>40</b>
<b>Kërkesa 4 e VKM-së - Kriteret e barazisë gjinore për fondet për zhvillimin e rajoneve .....</b>	<b>42</b>
Hyrje.....	43
Komiteti për Zhvillimin Rajonal.....	43
Roli i ministrive të linjës .....	45
Barazia gjinore - një mekanizëm vlerësimi dhe kontrolli.....	45
Veprimi për zbatimin.....	45
<b>Kërkesa 5 e VKM-së - Harmonizimi i BPGJ-së me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore.....</b>	<b>50</b>
<b>Kërkesa 6 e VKM-së - Përgjegjësia e ministrive lidhur me zbatimin e Vendimit.....</b>	<b>55</b>
Përgjegjësitë e përcaktuara .....	55
Struktura e Menaxhimit.....	55
<b>Kërkesa 7 e VKM-së - Çuarja përpara e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në PBA.....</b>	<b>62</b>
Vënia e hershme në zbatim .....	63
<b>Shtojcat .....</b>	<b>65</b>
Shtojca 1: Shembuj të integritit gjinor në disa programe buxhetore të MPCSSHB dhe MBUMK 2014-2016 - Udhëzimi nr.9, datë 22.02.2013 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016” .....	66
Shtojca 2: Disa shembuj të lidhjes së objektivave të SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 me programet buxhetore të ministrive të linjës jepen si më poshtë:.....	83
Shtojca 3: Shembuj ndërkombëtarë të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor .....	86



Hyrje

**Prirja globale drejt reformës buxhetore**

Gjatë viteve të fundit, shumë vende i kanë reformuar procedurat buxhetore për t'u përqendruar më shumë tek mënyra se si të përdoret buxheti për të planifikuar objektiva të caktuara të qeverisë, si edhe tek rezultatet e shpenzimeve publike. Ka shumë variacione të buxhetimit të mbështetur në rezultate ose në programe. Një karakteristikë thelbësore është largimi nga mbajtja në kontroll e faktorëve kontribues buxhetorë, duke e kaluar fokusin tek produkti ose rezultatet. Motivimi bazë është përmirësimi i efikasitetit dhe nxitja e llogaridhënies të orientuar nga rezultatet.

Përdorimi i informacioneve mbi rezultatet gjatë përgatitjes së buxhetit është një proces ambicioz dhe i ndërlikuar. Aspektet e reformës që kanë arritur më së shumti sukses kanë të bëjnë me riklasifikimin e buxhetit sipas fushave të programeve dhe me përdorimin e çmuarjeve shumëvjeçare mbi bazën e programeve ose fushave të produktit.

## Reforma administrative në Shqipëri

Reforma e procesit buxhetor ka disa vjet që ka filluar tashmë në Shqipëri. Në vitin 2005, është prezantuar Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI). Ky sistem është një kuadër planifikimi dhe monitorimi që synon të sigurojë që proceset qendrore politike dhe financiare të zhvilluara nga qeveria të funksionojnë në mënyrë të integruar. Këto procese qendrore janë:

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)**, që vendos objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të qeverisë dhe strategjitë për të gjithë sektorët.
- **Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)**, i cili kërkon që çdo ministri të përgatisë një plan trevjeçar për realizimin e produkteve të programeve, për të arritur objektivat e politikës, brenda tavaneve të shpenzimeve të ministrive, sikurse përcaktohen në planin fiskal të qeverisë.

Në vitin 2008, u miratua një ligj i ri organik për buxhetin, duke filluar kështu një reformë ambicioze buxhetore që përfshin si fazën e formulimit ashtu edhe atë të realizimit. Mes dispozitave të tjera, ligji i ri:



- Kërkon një shqyrtim në mes të vitit të procesit buxhetor,
- E përcakton më plotësisht kalendarin e përgatitjes dhe monitorimit të buxhetit,
- I identifikon më qartë rolet dhe përgjegjësitë,
- Krijon kuadrin për delegimin e administrimit të buxhetit,
- Prezanton mekanizma të tjerë të transparencës përmes kërkesave për të publikuar një plan buxheti afatmesëm dhe raportet e ecurisë, në hapësirën në internet të qeverisë.

Mes reformave të shumta në sektorin publik, në lidhje me buxhetimin, gjatë dekadës së fundit, efektin më të madh e ka arritur vendosja e fokusit tek ecuria e rezultateve. Informacionet për rezultatet në buxhet mund t'i ndihmojnë vendimmarrësit të vlerësojnë se si kontribuojnë programet e ndryshme në arritjen e politikave dhe prioritetëve të qeverisë. Aktualisht, shumica e shteteve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) u paraqesin parlamenteve dhe publikut objektivat për ecurinë e rezultateve, si pjesë e buxhetit.

## **Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, si element i reformës buxhetore**

Në vitet e fundit, në shumë vende të botës janë ndërmarrë inisiativa të buxhetimit gjinor, të udhëhequra nga aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë, dhe kryesisht nga organizata ndërkombëtare si Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).

Disa ekspertë të reformës buxhetore e kanë përshkruar buxhetimin e përgjigjshëm gjinor thjesht si “buxhetim i mirë” dhe e vënë theksin tek përfitimet pozitive ekstra që mund të sjellë një qasje e tillë<sup>1</sup>. Ekspertë të tjerë pranojnë se është “buxheti ku objektivat e politikave harmonizohen dhe zbatohen në mënyrë konkrete, duke realizuar kështu prioritetet ekonomike dhe politike të një vendi.”<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Stotsky, Janet. 2006. “Buxhetimi gjinor” material pune i FMN-së.

<sup>2</sup> Tony Hutton. 2001. Drejtor, Drejtorja e Administrimit Publik, OECD. Konferencë për fuqizimin e qeverisjes ekonomike dhe financiare. Bruksel, tetor.



Këndvështrimi gjinor duhet të reflektohet në ndarjen e burimeve dhe nëse nuk realizohet, ka shumë gjasa që rezultatet e politikave dhe programeve apo shërbimeve të mos arrihen. Buxhetet duhet të shikohen si mjete kritike për integrimin e këndvështrimit gjinor në proceset e zbatimit të politikave. Për më tej, buxheti gjinor është një mënyrë efikase për gratë dhe vajzat për tu përfshirë plotësisht në diskutimet dhe debatet mbi ndarjen e burimeve që mund të sjellin si rezultat fuqizimin e tyre dhe rritjen e përgjigjes së politikave ndaj nevojave të tyre. Së fundi, praktika e buxhetimit gjinor mund të nxisë pjesmarrjen qytetare dhe transparencën në qeverisjen e mirë.

Në thelb të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është përgjigja ndaj nevojave të marrësve të shërbimeve publike. Matja e shkallës me të cilën shërbimet publike (të parashikuara nga buxheti i shtetit) i përmbushin nevojat e grave dhe burrave (vajzave dhe djemve) për të cilët janë hartuar, përbën hapin e parë drejt nivelit ku buxheti do të ishte i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore. Një mënyrë tjetër për ta matur këtë është ndikimi që kanë shpenzimet buxhetore në barazinë gjinore: a nxitet barazia gjinore, a dobësohet ajo apo mbetet e pandryshuar si pasojë e masave buxhetore?


Një ngjashmëri e rëndësishme ndërmjet buxhetimit të bazuar tek programet ose rezultatet dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është se të dy lidhen me **planifikimin për rezultatet**. Krahas kësaj, të dy kanë të bëjnë me **matjen** e rezultateve të arritura dhe përdorimi i këtij informacion gjatë planifikimit të rezultateve të mëtejshme.

Ka edhe një ngjashmëri tjetër mbresëlënëse midis këtyre dy qasjeve:

- Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor **kapërcen hendekun** midis politikës së qeverisë për barazi gjinore dhe shpërndarjes së burimeve të nevojshme për ta vënë në zbatim këtë politikë.
- Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) lidh (ose **kapërcen hendekun**) e vendimmarrjes për politikën me vendimmarrjen financiare, me fokus të dyfishtë tek shqyrtimet politike të programeve DHE shpenzimet programore dhe planet e investimeve.

Në një sërë vendesh ka filluar të përdoret buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në kuadër të procesit të reformës buxhetore. Në këto vende përfshihen Austria, Koreja, Krahina Autonome e Andaluzisë dhe Bashkia e San Franciskos. Disa prej këtyre shembujve do t'i trajtojmë më me hollësi, më poshtë në këtë Udhëzues.





**Informacion i përgjithshëm  
për Vendimin e Këshillit të Ministrave  
Nr. 465, datë 18.07.2012**



Në muajin korrik 2012, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 465 (VKM), datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”.

Ky Vendim është një tjetër element i strategjisë së Qeverisë për barazinë gjinore. Një proces i njëkohshëm është futja e parimeve dhe objektivave të integritit gjinor në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020 (SKZHI), një projekt i ndërmarrë në verën e vitit 2012, në bashkëpunim me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Ndhmës së Huaj. Vendimi mund të konsiderohet edhe si pjesë e procesit të reformës së vazhdueshme administrative.

VKM-ja kërkon përgatitjen e një udhëzimi, për të ndihmuar personat përgjegjës brenda administratës të vënë në zbatim dispozitat e Vendimit. Fokusi kryesor do të jetë tek mënyra me të cilën duhet integruar perspektiva gjinore në kuadrin ekzistues të PBA-së. Vendimi e vë theksin tek një metodikë specifike, që është përcaktimi i objektivave të barazisë gjinore për programet buxhetore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE

## VENDIM

Nr. 465 datë 18.07.2012

PËR

### **PËR INTEGRIMIN GJINOR NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 2 e 13, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave.

### **VENDOSI:**

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në kërkesat buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015, brenda një ose dy programeve buxhetore, të përcaktojnë minimalisht një objektiv të politikës gjinore për të zbatuar integrimin gjinor në buxhetim.
2. Duke filluar nga viti 2013, të përfshihen në procesin e buxhetimit gjinor të gjitha ministritë e linjës.
3. Ministritë të përcaktojnë tregues të përshtatshëm dhe të matshëm gjinorë për objektivat dhe produktet e secilit program, për të cilin do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim.

4. Grantet që do të alokohen nga fondi për zhvillimin e rajoneve të marrin në konsideratë kritere që ndikojnë pozitivisht në barazinë gjinore.
5. Përcaktimi i programeve buxhetore, për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim, të bëhet mbështetur në objektivat e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, 2011-2015.
6. Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të këshillojë të gjitha ministritë për të përcaktuar programet buxhetore për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor.
7. Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e procedurave më të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ngarkohen të gjitha ministritë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

## U D H Ë Z I M

Nr. 21, datë 21.06.2013

“PËR

### **PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR INTEGRIMIN GJINOR NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe pikës 7 të VKM Nr. 465 datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Financave:

#### UDHËZOJNË:

1. Gjatë procesit të hartimit të kërkesave buxhetore, proces i cili mbështetet në Udhëzimin nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” si dhe udhëzimin vjetor dhe atë plotësues të përgatitjes së Programimit, Buxhetor Afatmesëm, në çdo Ministri Linje, strukturat përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e Programimit Buxhetor Afatmesëm duhet të mbajnë parasysh:

a) Përcaktimin e objektivave të barazisë/politikës gjinore, identifikimin e produkteve dhe vendosjen e treguesve të matshëm gjinorë.

b) Vendosjen e kritereve të barazisë gjinore në shpërndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

c) Harmonizimin e buxhetimit gjinor me Strategjinë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015”.

d) Ecurinë e buxhetimit gjinor për ministrinë përkatëse.

2. Ministritë e Linjës duhet që gjatë procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, të përzgjedhin brenda strukturës së tyre programe, ato programe buxhetore për të cilat do të zbatohet buxheti gjinor, mbështetur në objektivat e Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015”.

3. Gjatë procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore afatmesme, me qëllim integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm, Ekipet e Menaxhimit të Programeve në çdo ministri linje, ndjekin hapat e mëposhtëm:

*a. Identifikojnë programet specifike ku mund të integrohen objektivat gjinore;*

*b. Identifikojnë pabarazitë gjinore, në bazë të analizës dhe burimeve të të dhënave;*


*c. Përcaktojnë prioritet për barazinë gjinore në qëllimin e deklaratën e politikës së programit;*

*d. Përcaktojnë objektivat për barazinë gjinore në deklaratën e politikës së programit;*

*e. Shqyrtojnë dhe modifikojnë produktet dhe aktivitetet ekzistuese, për të arritur objektivat gjinore. Nëse është e nevojshme, identifikojnë produkte dhe aktivitete të reja;*

*f. Planifikojnë shpenzimet për produktet dhe aktivitetet e programit;*

3.1. Për procedura të detajuara në kuadër të integritimit gjinor në PBA, Ekipet



e Menaxhimit të Programeve, duhet ti referohen aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Objektivat, produktet dhe aktivitetet gjinore duhet të pasqyrojnë qartë se çfarë parashikohet të arrihet për çdo vit të PBA-së. Këto elemente duhet të jenë SMART, pra specifike, të matshëm (në terma sasiorë dhe cilësorë), të arritshëm, realistë dhe përcaktuar për t'u realizuar në një periudhë afatshkurtër deri afatmesme.

5. Në zbatim të pikës 4 të VKM nr. 465 datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës nëpërmjet Sekretariateve përkatëse për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, vlerësojnë kërkesat për grantet konkurruese të paraqitura nga njësitë e pushtetit vendor. Në kriteret e vlerësimit të projekteve të paraqitura për këtë qëllim, duhet të përfshihen edhe kritere për arritjen e barazisë gjinore. Për rrjedhojë, këto sekretariate, gjatë vlerësimit, monitorimit dhe raportimit të çdo projekti, duhet të mbajnë parasysh edhe integrimin e perspektivës gjinore.

6. Sekretariati i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (DEBASKON) pranë Këshillit të Ministrave, gjatë vlerësimit dhe miratimit të projekteve të dërguara nga sekretariatet përkatëse të ministrive të linjës, mban parasysh integrimin e perspektivës gjinore.

7. Një grup pune ndër ministror i udhëhequr nga MPÇSSHB (DPSHBF), në përbërjen e të cilit ka përfaqësues nga të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e SKBGJ-DHBGJ 2011-2015, duhet të koordinojë të gjithë procesin e buxhetimit dhe monitorimit të objektivave gjinorë në PBA.

8. Nëpunesi Autorizues i Ministrisë së Linjës/Koordinator i procesit të PBA-së, duhet të mundësojë:

*a. Ngarkimin e një punonjësi ekzistues me përgjegjësitë që lidhen me integrimin gjinor në procesin e hartimit të PBA/akteve të tjera ligjore e nënligjore, si edhe me raportimin mbi ecurinë e këtyre proceseve;*

*b. Trajtimin e çështjes së integritetit gjinor në rendin e punës së Grupit për Menaxhimin Strategjik, gjatë procesit të hartimit të PBA-së;*

9. Struktura përgjegjëse për Shanset e Barabarta pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, luan një rol këshillimor dhe koordinues

për nëpunësit gjinorë nëpër ministritë e linjës, gjatë procesit të integritimit gjinor në buxhetim.

10. Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për marrjen e masave për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



MINISTËR I PUNËS, ÇËSHTJEVE  
SOCIALE DHE SHANSEVE  
TË BARABARTA

---

SPIRO KSERA

MINISTËR I FINANCAVE

---

RIDVAN BODE

u d h e

## Pjesa e dytë

### **Qëllimi i këtij Udhëzuesi**

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë një praktikë për integrimin gjinor në procesin e planifikimit buxhetor të programeve dhe politikave të ndryshme të hartuara nga ministritë e linjës përgjatë procesit të PBA-së.

Ky udhëzues është hartuar për të lehtësuar formulimin e objektivave të ndjeshëm gjinorë, hartimin e produkteve gjinore, aktiviteteve dhe buxheteve në PBA nga specialistët e politikave dhe të buxheteve në ministritë e linjës, me qëllim formulimin e buxheteve që synojnë arritjen e barazisë gjinore.

# zuesi



**Si ta kuptojmë**

**Vendimin e Këshillit të Ministrave**

## Baza ligjore

Në tekstin e Vendimit përmendet baza ligjore e tij. Kjo bazë është e trefishtë:

- Neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili bën fjalë për kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke përfshirë edhe kompetencën për të nxjerrë vendime;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (nenet 2 e 13), që kanë të bëjnë me integrimin e çështjeve gjinore si qëllim i ligjit dhe me dispozitën për bërjen e shtesave dhe ndryshimeve dhe miratimin e akteve nënligjore të nevojshme.

## Dispozitat e Vendimit

Vendimi nr. 465 parashikon marrjen e disa masave nga ana e administratës së Republikës së Shqipërisë gjatë përgatitjes së PBA-së. Ato janë:

- Përcaktimi i objektivave të barazisë / politikës gjinore, identifikimi i rezultateve dhe vendosja e treguesve.
- Vendosja e kriterëve të barazisë gjinore për fondet e zhvillimit të rajoneve.
- Harmonizimi i buxhetimit gjinor me strategjinë kombëtare për barazinë gjinore, eliminimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Përgjegjësitë e ministrive lidhur me zbatimin e Vendimit.
- Ecuria e buxhetimit gjinor në të gjitha ministritë e linjës.





**Përse duhet përfshirë  
aspekti gjinor në buxhet?**

## Hendeku mes politikave dhe buxhetit

Historikisht ka pasur një hendek mes mënyrës si planifikojnë qeveritë, si i miratojnë dhe zbatojnë politikat dhe mënyrës se si i financojnë këto politika. Për shembull, një gjë është të miratosh një politikë që kërkon që gratë të gëzojnë mundësi të barabarta hyrjeje në tregun e punës, apo që diskriminimi gjinor bie ndesh me ligjin kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e punës, apo që eliminimi i dhunës kundër grave është pjesë e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore. Tjetër gjë është të parashikosh fonde në buxhet në mënyrë që këto politika të financohen e të bëhen të realizueshme. Hendeku mes miratimit të politikave dhe bërjes së buxhetit mund të dallohet në të gjitha fushat e politikave dhe nuk vlen vetëm për fushën e barazisë gjinore. Shembuj ka në çdo sektor, se si nuk vihen në zbatim politikat, apo se si vihen në zbatim vetëm pjesërisht, ngaqë gjatë procesit të planifikimit nuk është bërë shqyrtimi i burimeve buxhetore në dispozicion.

## Integrimi i çështjeve gjinore - përshpejtimi i barazisë gjinore

Edhe pse gratë e kanë fituar de jure barazinë përmes legjislacionit për luftën kundër diskriminimit dhe për nxitjen e mundësive të barabarta, shumë gra ende nuk përjetojnë barazi të qenësishme në jetën e përditshme. Për të arritur një barazi de fakto, nevojitet një qasje e re. Integrimi i aspektit gjinor është diskutuar për herë të parë në konferencën e tretë botërore të OKB-së për gratë, të zhvilluar në vitin 1985. Pas Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, të mbajtur në Pekin në vitin 1995, në mbarë botën u promovua strategjia e integrimit të aspektit gjinor. Komisioni Evropian kishte filluar ta shihte mundësinë e zbatimit të tij përpara konferencës së Pekinit, dhe e miratoi integrimin e aspektit gjinor si strategji në vitin 1996. Në vitin 1999, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, integrimi gjinor mori status juridik si angazhim për eliminimin e pabarazive dhe promovimin e barazisë mes grave dhe burrave në të gjitha veprimtaritë e Komunitetit.



## Përkufizimi i integritit të aspektit gjinor

Sipas përkufizimit që i bën Këshilli i Evropës, integrimi gjinor është:

“(ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë të atillë që perspektiva e barazisë gjinore të integrohet në të gjitha politikat në të gjithë nivelet dhe të gjitha fazat, nga të gjithë aktorët e angazhuar në hartimin e politikave”

Fokusi themelor është tek ndryshimi i mënyrës si bëhen politikat, në mënyrë që çdo fazë e procesit të mbështetet tek objektivi madhor i barazisë gjinore. Kjo metodikë kërkon parakushtet për funksionimin me sukses të integritit gjinor. Ato janë:

- vullneti politik
- burime adekuate, të mjaftueshme
- statistika të zbërthyera sipas gjinive
- trajnimi i nëpunësve civilë
- zhvillimi i një infrastrukture, siç janë pikat qendrore të kontaktit
- një përfaqësim sa më i barabartë i grave dhe burrave në proceset vendimmarrëse
- transparencë në proceset e bërjes së politikave<sup>3</sup>

## Përkatësia gjinore dhe ekonomia

Teoria ekonomike dhe planifikimi nuk e marrin në konsideratë aspektin gjinor. Rolet që kanë gratë dhe burrat në shoqëri nuk merren në konsideratë në parashikimet që bëjnë ekonomistët, as në mënyrën se si ndërtohen kornizat makroekonomike. Në nivel bazë të mendimit ekonomik, njerëzit (si burrat, edhe gratë) konsiderohen si konsumatorë (të shërbimeve publike, dhe të produkteve të tregut). Ekonomia funksionon pa marrë

<sup>3</sup> Këshilli i Evropës, grupi i specialistëve, “Integrimi gjinor: kuadër konceptual, metodika dhe paraqitja e praktikave të mira”.



në konsideratë aspektin gjinor: modelimi ekonomik ka asnjë gjinore. Për analogji, edhe procesi i miratimit të buxhetit kombëtar ka qenë asnjë nga ana gjinore, pa marrë në konsideratë se çfarë ecurie kanë burrat dhe gratë në ekonomi dhe se si reagojnë ndaj masave buxhetore.

Një nga mënyrat më mbresëlënëse me të cilën ndikojnë rolet gjinore në ekonomi janë mënyrat e ndryshme me të cilat gratë dhe burrat kontribuojnë në punët dhe kujdesin shtëpiak dhe në komunitet. Kjo punë quhet “ekonomia e përkujdesjes”, ose “punë e papaguar e gruas”, sepse janë gratë ato që bëjnë shumë më shumë nga kjo lloj pune se sa burrat. Shumë prej punëve të shtëpisë janë të nevojshme për mbajtjen e ekonomisë. Për të punuar jashtë shtëpisë dhe për të prodhuar mallra, duhet mirëmbajtur edhe shtëpia e familja, duhet përgatitur ushqimi, duhet bërë pazari e duhen larë dhe hekurosuar rrobat. Të gjitha këto janë kontribute për ekonominë, e megjithatë për to nuk paguhet asnjë rrogë.

Kur ekonomia është në vështirësi apo në rënie, ekziston rreziku i shkurtimit të shërbimeve publike. Kjo mund të çojë në shkurtime në kujdesin shëndetësor, kujdesin për fëmijët, ndihmën ekonomike dhe në shërbimet e tjera publike. Duke qenë se gratë janë ato që i përdorin shërbimet publike më shumë se burrat, kur ka një shkurtim të tyre mbi to bie një barrë më e madhe për përkujdesjen. Përgjegjësitë që kanë për përkujdesjen do të thotë se grave u mbetet më pak kohë për të ndjekur veprimtari të tjera, duke përfshirë edhe veprimtaritë e tregut të punës. Një ndikim tjetër i një ekonomie në vështirësi është shpesh shkurtimi i vendeve të punës në sektorin publik dhe shpesh kjo mund të prekë më shumë gratë se burrat.

## **Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor – përsheptimi i barazisë gjinore përmes buxhetit**

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor pranon se gratë dhe burrat kanë marrëdhënie të ndryshme me ekonominë. Po ashtu, kjo ka të bëjë edhe me faktin se nëse duam të arrijmë progres të qenësishëm për barazinë gjinore, politikat pa buxhetet nuk mjaftojnë. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor kërkon që buxhetet t’u përgjigjen më mirë nevojave të njerëzve. Qëllimi është të integrohet aspekti gjinor si një kategori



analize dhe kontrolli në procesin buxhetor. Logjika mbi të cilën mbështetet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është se, si të gjitha politikat shtetërore, buxheti i prek ndryshëm gratë dhe burrat për shkak të nevojave dhe roleve të tyre mbi baza gjinore. Synimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është së sigurojë që masat e buxhetit të shtetit (si nga ana e shpenzimeve, ashtu edhe nga ana e të ardhurave të buxhetit) të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave dhe të vajzave dhe djemve; të sigurojë që buxheti kontribuon në zvogëlimin e pabarazisë gjinore; dhe të realizojë shërbime publike në mënyrë që të rritet barazia gjinore.

## Kapërcimi i këtij hendeku

Në Shqipëri, sistemi i planifikimit të integruar është një mënyrë për të ndërthurur planifikimin strategjik të politikave me planifikimin dhe administrimin e buxhetit, burimet buxhetore me objektivat e politikave dhe për të siguruar koherencë ndërmjet SKZHI-së dhe PBA-së. Buxhetimi buxhetor kapërcen hendekun midis politikës për barazi gjinore dhe burimeve të nevojshme për arritjen e barazisë gjinore.

## Përkufizimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor

Këshilli i Evropës e përkufizon buxhetimin e përgjigjshëm gjinor si një zbatim të integritit të çështjeve gjinore në procesin buxhetor. Për ta kuptuar këtë përkufizim, është e nevojshme të shohim edhe një herë përkufizimin e integritit të çështjeve gjinore, të paraqitur më lart në këtë udhëzues. Integrimi i çështjeve gjinore përkufizohet nga Këshilli i Evropës si:

“(ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë të atillë që perspektiva e barazisë gjinore të integrohet në të gjitha politikat në të gjithë nivelet dhe të gjitha fazat, nga të gjithë aktorët e angazhuar në hartimin e politikave”

Praktika e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor filloi në Australi në mesin e viteve '80 të shekullit të mëparshëm. Qeveria australiane e njohu faktin se nëse duhej çuar përpara



barazia gjinore, atëherë duhej zbatuar në buxhet integrimi i çështjeve gjinore, me të njëjtën mënyrë sikurse zbatohet edhe në fushat e tjera të politikave. Prej atëherë, shumë vende në mbarë botën, nga lindja në perëndim, nga jugu në veri, kanë ndërmarrë të njëjtin projekt lidhur me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Sot mund t'i hedhim sytë nga Austria si një shembull i shkëlqyer i mënyrës me të cilën mund të merret në konsideratë ndikimi gjinor në të gjitha nivelet e administrimit të buxhetit dhe si vendi ku kushtetuta kërkon që barazia e efektshme ndërmjet grave dhe burrave të jetë parim kyç i bërjes së buxheteve.

Për më shumë informacion për historinë dhe zhvillimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe për shembuj të zbatimit të tij, shihni


Hapësirën e dedikuar në internet të organizatës “UN Women”, me adresë [www.gender-budgets.org](http://www.gender-budgets.org)

Materialin e Këshillit të Evropës “Buxhetimi: manual praktik për zbatimin” në adresën [www.coe.int](http://www.coe.int)



# Kërkesa 1 e VKM-së

**Përcaktimi i objektivave gjinorë  
në programet buxhetore**



## Hyrje

Kjo rubrikë është strukturuar si më poshtë:

- Përshkrimi i qasjeve që përdoren në nismat e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor të drejtuara nga qeveria në mbarë botën
- Vendimi i Këshillit të Ministrave identifikon një të një prej këtyre qasjeve si ajo që duhet përdorur për PBA-në
- Struktura dhe proceset e ndjekura në hartimin e PBA-së
- Integrimi i çështjeve gjinore në PBA kërkon përdorimin e të njëjtit proces dhe futjen e konsideratave gjinore në qendër të punës
- Burimet e të dhënave për të asistuar me përkufizimin e objektivave të barazisë gjinore

## Përgatitja e një metodike

Përgjithësisht, ka dy qasje për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

**Qasja 1:** Vendosja e një ose më shumë objektivave për barazinë gjinore dhe hartimi i aktiviteteve të duhura dhe identifikimi i fondeve të miratuara në buxhet për t'i arritur këta objektiva.

**Qasja 2:** Shqyrtimi sistematik i të gjithë zërave buxhetorë me objektiv bërjen e ndryshimeve të nevojshme për të realizuar rezultate më të mira për barazinë gjinore.

Qasja 1 është qasja e përdorur nga qeveria austriake, ndërsa qasja 2 është metodika e përdorur nga qeveria belge. Dallimi strategjik ndërmjet dy qasjeve është se, në rastin e qasjes së parë, vëmendja është e përqendruar tek statusi i barazisë gjinore në sektor dhe identifikimi i objektivave të rinj buxhetor; dhe, në rastin e dytë, fokusi është tek aktivitetet dhe masat ekzistuese buxhetore për të përcaktuar nëse njëra gjini preket negativisht ose nëse mund të përmirësohet barazia gjinore duke përshtatur strukturën ose realizimin e aktivitetit.



## Integrimi i perspektivës gjinore në PBA

Qasja e miratuar me VKM nga Këshilli i Ministrave përcakton objektivat për barazinë gjinore brenda kuadrit të programeve buxhetore. Kjo është e ngjashme me Qasjen 1, të përmendur më lart, dhe, për rrjedhojë, është e ngjashme me qasjen e ndjekur nga qeveria e Austrisë.

Integrimi i perspektivës gjinore në PBA, siç e kërkon VKM-ja, do të thotë integrim i perspektivës gjinore në procesin buxhetor ekzistues. Ky proces parashikohet në Udhëzimin nr. 8 datë 29.03.2012 “ Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe në udhëzuesit sektorialë. Më poshtë jepet një përmbledhje e këtij procesi.

## Struktura dhe proceset e PBA-së


Pema programore

Fusha e kompetencës së çdo ministrie organizohet sipas programeve. Një program përmban të gjithë punën që shoqëron një fushë koherente të politikave. Të gjitha institucionet buxhetore kanë një program që merret me planifikimi e administrimit. Kështu, ky program qëndron më vete nga fusha e kompetencës së qeverisë për politikën publike.

Pema programore është një instrument kyç i planifikimit organizativ. Është një mënyrë diagramatike për të përshkruar punën e planifikuar të programit. Ajo tregon shpërndarjen e fondeve të buxhetit detyrave të veçanta (aktiviteteve) dhe lidhjen midis këtyre detyrave dhe synimeve programore.


Përshkrimi i Programit është një tekst i thjeshtë ku përshkruhen kompetencat e programit.

Deklarata e Politikës së Programit vë në pah politikën për të cilën është përgjegjës Programi. Në këtë aspekt duhet të jetë koherent me dokumentet publike ku shprehet kjo politikë, duke përfshirë edhe Programin e Qeverisë, Planin Kombëtar për Zhvillim dhe Integrim, Strategjinë Sektoriale dhe Planin e Zbatimit për Marrëveshjen e Strabilizim-Asocimit.



Shuma gjithsej e fondeve të shpërndara të aktiviteteve është e barabartë me shpenzimet gjithsej të buxhetuara të programit.

Nga një këndvështrim i planifikimit strategjik të politikave, pema programore tregon se si teksti i një qëllimi afatgjatë të politikës shndërrohet në një grup detyrash konkrete (aktivitetesh) që do të realizohet vit pas viti dhe do të sjellë produktet, të cilat mund të maten dhe monitorohen për të siguruar zbatimin e politikës së synuar.



## Objektivat

Brenda kuadrit të pemës programore, identifikimi i objektivave është qartësisht një element jetik. Objektivat përfaqësojnë zberthimin fillestar të synimit të programit në drejtim të realizimit të atij synimi.

Në kushtet e Shqipërisë, objektivat përcaktojnë arritjet e planifikuara në çdo vit të kuadrit afatmesëm. Sipas manualit operativ të PBA-së, objektivi është:

- Arritje specifike e politikës, e matur saktësisht sa i takon kohës, sasisë dhe kostos, që mund të realizohen gjatë periudhës së PBA-së dhe që përbën hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimit të politikës.

Të gjitha shpenzimet e ministrisë duhet të kontribuojnë në objektivat e shprehur të politikës.

### **Karakteristikat e objektivit**

- Duhet të thotë qartë se çfarë planifikon të arrish deri në fund të vitit
- Duhet të jetë i matshëm - i mundshëm për t'u vlerësuar
- Jo përshkrim i mjeteve për të planifikuar arritjen e objektivit
- Mjetet (mënyrat) shfaqen si produkte dhe aktivitete
- Një gabim i zakonshëm është ngatërimi i objektivave me produktet

Ka një ngjashmëri të qartë ndërmjet objektivave në kontekstin shqiptar dhe objektivave të rezultateve në kontekstin austriak.

### **Objektivat dhe produktet**

Çdo objektiv ka një ose më shumë produkte. Produkti mund të konsiderohet si një produkt i realizuar ose shkaktuar nga një fond buxhetor. Sipas manualit operacional, produktet janë:

- Mallrat dhe shërbimet që duhen prodhuar për të kontribuar në arritjen e objektivave afatmesme dhe qëllimeve afatgjata.


### **Procesi i përgatitjes së buxhetit në nivel të ministrisë së linjës**

Ka dy grupe kryesorë aktorësh të përfshirë në përgatitjen e PBA-së.

1. Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP)
2. Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)



Përbërja dhe rolet e tyre përshkruhen në diagramin e mëposhtëm. Në thelb, Ekipi i Menaxhimit të Programit përbëhet nga specialistë të fushës buxhetore në fjalë dhe është përgjegjës për detyrat teknike të identifikimit të produkteve dhe aktiviteteve të lidhura me programin. Grupi për Menaxhimin Strategjik është një grup i nivelit të lartë i përbërë nga ministria dhe zëvendësministra dhe është përgjegjës për dhënien e orientimeve, vendosjen e prioriteteve dhe dhënien e miratimit.



## Mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit

Ekipi i Menaxhimit të Programit zhvillon një sërë mbledhesh në kuadër të përgatitjes së PBA-së. Puna e kryer gjatë këtyre mbledhjeve lidhet, sipas nevojës, me Grupin për Menaxhimin Strategjik për orientim dhe miratim. Nga këto, ka gjashtë mbledhje kyçe. Tabelat më poshtë japin informacion për punimet e këtyre gjashtë mbledhjeve kyçe:

### Deklarata e politikes se programit (DPP)

- Shqyrton dokumentet e lidhura, strategjite e sektorit, programin e Qeverisë
- Miraton rishikimet e Deklaratës së politikës së programit
- Vendos në lidhje me detyrimet e VKM-së
- Nënshkruan DPP dhe ia paraqet Koordinatorit të GMS

### Projekti, produktet, aktivitetet

- Merr raportin me tavanet programore nga Koordinator i GMS
- Përcakton produktet
- Përcakton aktivitetet
- Përgatit pemën programore

### Përgatitet kerkesat e buxhetit

- Vendos objektivat sasiore të produkteve
- Cakton shpenzimet per aktivitetet
- Kontrollon dhe mbyll nëse ka boshllëqet në financim përmes rishikimit të objektivave sasiore
- Nënshkruan raportin e produkteve dhe shpenzimeve
- Dorëzon raportin për produktet dhe shpenzimet tek Koordinatori i GMS



### Shqyrton kërkesat

- Raportet e reja të produkteve dhe shpenzimeve sipas kërkesave në bazë të ndryshimeve të tavaneve
- Harton formularët e buxhetit plotësues
- Paraqet versionin përfundimtar të raporteve të produkteve dhe shpenzimeve pranë koordinatorit të GMS

### Finalizimi i kërkesave

- Zbaton vendimet e GMS dhe përgatit versionet përfundimtare të Deklaratave të Politikës së Programit, raportet e produkteve dhe shpenzimeve dhe formularët e buxhetit shtesë

### Finalizon kërkesat shtesë të PBA-së

- Vendos objektivat sasiorë të produktit
- Cakton shpenzimet për aktivitetet
- Kontrollon dhe mbyll boshllëqet e financimit duke rishikuar objektivat sasiorë
- Nënshkruan raportin e produkteve dhe shpenzimeve
- I paraqet raportin e produkteve dhe shpenzimeve Koordinatorit të GMS



## **Integrimi i perspektivës gjinore në procesin e PBA-së**

Sikurse është thënë më lart në këtë Udhëzues, fokusi themelor i integrimit të perspektivës gjinore është tek ndryshimi i mënyrës se si bëhen politikat dhe tek futja e konsideratave gjinore në qendër të procesit normal të vendimmarrjes. Praktika e formulimit të objektivave dhe identifikimit të produkteve dhe aktiviteteve që do të realizojnë qëllimet e programit është konsoliduar tashmë në procesin e PBA-së në Shqipëri. Po i njëjti proces është mirë të përdoret për të identifikuar objektivat për barazinë gjinore në buxhet.

### **Hapat për përcaktimin e objektivave për barazinë gjinore**

1. Identifikimi i programeve specifike ku mund të integrohen objektivat gjinore;
2. Identifikimi i pabarazive gjinore, në bazë të analizës dhe burimeve të të dhënave;
3. Përcaktimi i prioriteteve për barazinë gjinore në qëllimin e deklaratën e politikës së programit;
4. Përcaktimi i objektivave për barazinë gjinore në deklaratën e politikës së programit;
5. Shqyrtimi dhe modifikimi i produkteve dhe aktivitete ekzistuese, për të arritur objektivat gjinore. Nëse është e nevojshme, identifikimi i produkteve dhe aktiviteteve të reja;
6. Planifikimi i shpenzimeve për produktet dhe aktivitetet e programit;
7. Përcaktimi i strukturës së menaxhimit



## Burimet e të dhënave për përcaktimin e objektivave të barazisë gjinore

Burimet e mundshme të informacionit janë:

Treguesit e Harmonizuar për Barazinë Gjinore dhe Statusin e Grave në Shqipëri

Botimet me çështjet gjinore në fokus, të MPÇSSHB-së, qendrave kërkimore universitare, faqeve në internet të OJQ-ve

Raporte dhe vrojtime të INSTAT-it ([www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)) dhe Eurostatit (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu>)

Raporte të Ministrisë së Integritetit mbi detyrimet e Shqipërisë

Raporte dhe vrojtime të Komisionit Evropian ([www.ec.europa.eu/justice/gender-equality/index\\_en.htm](http://www.ec.europa.eu/justice/gender-equality/index_en.htm)) dhe nga Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore ([www.fra.europa.eu/fra\\_website/home/home\\_en.htm](http://www.fra.europa.eu/fra_website/home/home_en.htm)), dhe nga Këshilli i Evropës ([www.coe.int](http://www.coe.int))

Raporte dhe vrojtime të Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë ([www.equineteurope.org](http://www.equineteurope.org))

Raporte dhe vrojtime të Institutit Evropian të Barazisë Gjinore (EIGGE) ([www.eige.europa.eu](http://www.eige.europa.eu))

Raporte dhe vrojtime të Lobit Evropian të Grave ([www.womenlobby.org](http://www.womenlobby.org))

Informacioni nga disa prej burimeve të mësipërme mund të vlejë për ta drejtuar vëmendjen nga prirjet në mbarë Evropën, të cilat mund të jenë ose jo aktuale për Shqipërinë.

Konsultimet me Drejtorinë e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si edhe me organizatën “UN Women” dhe me OJQ-të përkatëse, do të ndihmojnë që të vendoset fokusi tek fushat me prioritet për Shqipërinë.



## Rekomandime


Është mirë që kjo punë të përfshihet në mbledhjet normale të punës të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe të Grupit për Menaxhim Strategjik.

Në fazën fillestare është mirë që në dispozicion të Ekipit të Menaxhimit të Programit të vihen njohuri prej eksperti për çështjet gjinore (si të Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes pranë MPÇSSH-së, ashtu edhe të një eksperti të pavarur vendas.

## Instrumentet e Sekretariatit të Bashkësisë së Shteteve

Sekretariati i Bashkësisë së Shteteve e porositi këtë paketë prej 7 instrumentesh në vitin 1999. Disa prej tyre janë modeluar mbi instrumente konvencionale të analizës ekonomike.

- 1. Vlerësimi i përfituesve i zbërthyer sipas gjinive i realizimit të shërbimeve publike dhe i prioriteteve buxhetore.** Mbështetet në informacionet josasiore të marra përmes sondazheve, grupeve të diskutimit, vrojttimeve të sjelljes, etj., ku pyeten përfituesit se sa të kënaqur janë nga politikat e qeverisë.
- 2. Analiza e shpërndarjes së shpenzimeve publike e zbërthyer sipas gjinive.** Ky është një instrument sasior i cili mat kostot për njësi të shërbimeve publike dhe mënyrën me të cilën shpërndahen shpenzimet mes grave dhe burrave.
- 3. Vlerësimi i politikave sipas perspektivës gjinore.** Ky instrument përdoret për të vlerësuar politikat mbi të cilat mbështetet shpërndarja e fondeve të buxhetit në mënyrë që të identifikohet efekti i mundshëm i tyre tek gratë dhe burrat. Ai vendos pikëpyetje mbi supozimin se politikat e buxhetit janë “asnjanëse nga ana gjinore” sa i takon ndikimit të tyre.
- 4. Deklarata e buxhetit që merr në konsideratë perspektivën gjinore.** Ky instrument përdoret për të treguar se si shpenzimet publike, në tërësi, por edhe shpenzimet publike sipas ministrive sektoriale, priten të trajtojnë çështjet e pabarazisë gjinore. Ai kërkon zberthimin e shpenzimeve në kategori gjinore.



- 5. Analizë e zbërthyer sipas gjinive e buxhetit lidhur me përdorimin e kohës.** Ky instrument është një mënyrë për të identifikuar marrëdhënien ndërmjet buxhetit kombëtar dhe punës së papaguar, shpesh e quajtur ekonomia e përkujdesjes. Objektivi është gjetja e një mënyre për të matur në formë sasiore punën pa pagë, konstatimi i shpërndarjes mes grave dhe burrave dhe hartimi i politikave përkatëse buxhetore.
- 6. Kuadri afatmesëm i politikave ekonomike që është i ndjeshëm ndaj aspektit gjinor.** Kornizat makroekonomike afatmesme aktuale hartohen duke përdorur një larmi modelesh mbarëekonomike, por asnjëri prej tyre nuk merr në konsideratë çështjet gjinore. Integrimi i perspektivës gjinore mund të arrihej ose përmes zbërthimit të ndryshoreve ose përmes ndërtimit të modeleve të reja që të jenë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore.
- 7. Analiza e mbledhjes së të ardhurave publike e zbërthyer sipas gjinive.** Ky instrument shqyrton format e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të tatimit në mënyrë që të llogaritet se sa tatim paguajnë kategoritë e ndryshme të individëve ose familjeve.





# Kërkesa 3 e VKM-së

**Përcaktimi i treguesve të matshëm gjinorë  
për objektivat dhe produktet e secilit program,  
në ministritë e linjës**

Në zbatim të këtij Vendimi të gjitha ministrinë e linjës duhet përcaktojnë tregues të përshtatshëm dhe të matshëm për barazinë gjinorë, brenda programeve për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim. Për këtë qëllim specialistët e politikave ndjekin hapat e mëposhtëm: **(një përshkrim konkret gjendet në shtojcën 1)**

1. Në fazën e rishikimit të politikës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon programin dhe planin e tij, që përshkruhen më tej në përshkrimin e programit.
2. Mbas përcaktimit të programit dhe planit, ekipi i menaxhimit të programit identifikon pabarazitë gjinore që ekzistojnë brenda programit në bazë të analizës dhe burimeve të të dhënave
3. Përshkruhen prioritetet për barazinë gjinore në deklaratën e politikës së programit (në përshkrimin e politikës së programit / qëllimin e politikës).

Politika e programit. Politikat që do të ndiqen në kuadër të këtij programi fokusohen në mbrojtjen e grupeve në nevojë nga varfëria dhe përjashtimi social duke siguruar akses të barabartë në sistemin e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta për individin (grua apo burrë) dhe familjen. Zgjerimi, përmirësimi dhe mbulimi me llojshmëri shërbimesh, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individët (gra dhe burra), familjet, grupimet dhe komunitetet të vetë-funksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë në zhvillimet shoqërore.

4. Përcaktimi i objektivave të ndjeshëm gjinorë, të cilat theksojnë artijen e barazisë gjinore nëpërmjet këtij objekti.
5. Modifikimi i produkteve dhe aktiviteteve ekzistuese, brenda të njëjtit objektiv, për të eliminuar pabarazinë gjinore dhe arritur objektivat gjinore. Nëse është nevoja, merr shumë rëndësi përcaktimi i produkteve dhe aktiviteteve të reja.
6. Llogaritja e kostos së produkteve dhe aktiviteteve me fokus të veçantë në produktet që synojnë shpërndarjen e drejtë të burimeve si dhe reduktojnë pabarazitë.
7. Përcaktimi i strukturës së menaxhimit .Drejtoria e Programimit të Politikave të Zhvillimit Rural



A stylized map of Kosovo, divided into several irregularly shaped regions. The regions are colored in shades of yellow, grey, blue, and teal. The map is positioned in the background, with the text overlaid on it.

# Kërkesa 4 e VKM-së

**Kriteret e barazisë gjinore për fondet  
për zhvillimin e rajoneve**

## Hyrje

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) në Shqipëri është ngritur me ligj në vitin 2009 dhe është futur në planifikimin e buxhetit në vitin 2010. Ky fond financon projekte që ndodhen në territorin e kompetencës së njësive të pushtetit vendor. Ky fond është një sistem grantesh konkurruese, ku mbulohen:

- infrastruktura vendore,
- arsimi bazë, parauniversitar dhe universitar,
- shëndetësia,
- objektet kulturore dhe trashëgimia kulturore,
- objektet e ujësjellës-kanalizimeve,
- objektet e tregjeve ushqimore-bujqësore dhe të thertoreve,
- kullimi dhe ujitja,
- pyllëzimi.

Kriteret bazë për përzgjedhjen e projekteve dhe shpërndarjen e fondeve janë:

- Numri i popullsisë për rajon
- Niveli i varfërisë
- Përfitimi nga investimi në 4 vitet e fundit

## Komiteti për Zhvillimin Rajonal

Këtij Komiteti, i ngritur me ligj në vitin 2009, dhe i kryesuar nga Kryeministri, i është ngarkuar detyra e administrimit të Fondit. Anëtarët e tjerë përfshijnë ministrat përkatës rajonalë dhe titullarët e një sërë organesh që kanë përgjegjësinë për çështjet e qeverisjes rajonale.



## **Komiteti ka tre funksione kryesore lidhur me fondin:**

### **Miraton:**

Kriteret për shpërndarjen e fondeve mes rajoneve, mbështetur në propozimin e Sekretariatit të Përgjithshëm

Shpërndarjen e fondeve për projektet sipas rajoneve respektive, mbështetur në propozimet e Sekretariatit të Përgjithshëm.

Projektet mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë.

### **Jep orientime:**

Për shpërndarjen sipas zonave të fondit total të buxhetit të caktuar për projektet e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, përpara miratimit të projektbuxhetit për vitin e ardhshëm nga Këshilli i Ministrave.

### **Cakton:**

Masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e pushtetit vendor.

## **Roli i ministrive të linjës**

Ministritë përkatëse të linjës fillimisht vlerësojnë kërkesat për grantet konkurruese që paraqesin njësitë e pushtetit vendor. Këtë detyrë e kryen Sekretariati i ngritur enkas për Fondin pranë ministrive të linjës. Krahas kësaj, Sekretariati monitoron dhe raporton për zbatimin e projekteve.

## **Sekretariati kryen funksionet e mëposhtme:**

- Bën vlerësimet teknike dhe ekonomike të projekteve të propozuara
- Ia përcjell listën e projekteve së bashku me vlerësimet Sekretariatit të Përgjithshëm
- Monitoron ecurinë e projekteve



- Kontrollon zbatimin e Fondit
- I raporton Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me ecurinë e projekteve
- I raporton Buxhetit të MF-së sipas Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit

## Barazia gjinore - një mekanizëm vlerësimi dhe kontrolli

### Shqyrtimi

Nga informacioni i mësipërm, mund të bëjmë këto komente:

- Ky është një fond i ri, me strukturë të re administrative
- Kriteret bazë janë të caktuara: i) numri i popullsisë, ii) niveli i varfërisë, iii) performanca
- Grantet miratohen në formë konkurruese
- Vlerësimi fillestar është teknik
- Vendimet përfundimtare i merr Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

Në lidhje me VKM-në për integrimin gjinor në buxhet, mund të arrijmë në përfundimin se kërkesa për të shtuar kriteret e barazisë gjinore në procesin e paraqitjes së kërkesave pranë FZHR-së vjen në momentin e duhur. I gjithë procesi është i ri dhe në zhvillim dhe, për rrjedhojë, detyra e shtimit të një elementi të ri nuk duhet të jetë e vështirë.

## Veprimi për zbatimin

Për të përmbushur këtë kërkesë, nevojitet veprim në 5 fronte:



## Identifikimi i kriterëve të barazisë gjinore

### Pyetje:

Pyetja që të vjen menjëherë në mendje dhe që është e rëndësishme, është:

A duam të zbatojmë kriteret e barazisë gjinore për projektet, apo për rajonet? Apo të përpiqemi të gjejmë një drejtpeshim midis këtyre dy dimensioneve?

### Përgjigje

Përgjigjja pragmatike do të ishte:

Të mbahen të dyja perspektivat në mendje. Të gjendet drejtpeshimi, në bazë të kërkesave për grante. T'i jepet mundësi sistemit të zhvillohet me kalimin e kohës. Të dokumentohet procesi.

### Hapat e procesit

1. Të konstatohet nëse ka apo jo pabarazi gjinore rajonale
2. Të shikohet Strategjia Kombëtare për Barazisë Gjinore, Eleminimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje
3. Të merret mendimi i shoqërisë civile dhe qytetarëve në nivel rajonal
4. Të konstatohen kriteret/treguesit gjinorë të situatës bazë sipas sektorëve
5. Të përcaktohet metodika e përcaktimit të prioriteteve gjinore
6. Shembull i metodikës me shkallën “G”, Andaluzi
7. Të caktohet një përfaqësues nga MPÇSSHB pranë Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve
8. Të merret në konsideratë ekspertiza shtesë gjinore si anëtarë ose këshilltarë të Komitetit

### Rekomandim

Veprimi në këtë front (Identifikimi i kriterëve të barazisë gjinore) është më i vështiri nga të gjitha veprimet e tjera. Kjo vlen njësoj për të gjitha kërkesat e tjera të VKM-së.



Përfshirja e barazisë gjinore kërkon një mënyrë tërësisht të re të menduari. Për këtë, është shumë i rëndësishëm rekomandimi i mëposhtëm:

Të ngrihet një grupi pune ndërrikasterial për hartimin e një pakete të treguesve/kritereve të barazisë gjinore e cila mund të përdoret si bazë fillestare dhe mund të zbatohet për të gjitha kërkesat e VKM-së. Është mirë që grupi i punës të kryesohet nga një nëpunës gjinor nga MPÇSSHB-ja dhe të përfshijë ekspertë të çështjeve gjinore.

## Trajnimi

Sikurse të gjitha risitë organizative, trajnimi është jetik. Gama e aktorëve të përfshirë në Fondin për Zhvillimin e Rajoneve është e gjerë. Për të maksimizuar rezultatet e barazisë gjinore – për të vendosur me të vërtetë kritere të barazisë gjinore si një mekanizëm vlerësimi dhe kontrolli në FZHR – u duhet siguruar trajnim:

- Njësive të qeverisjes vendore
- Propozuesve të tjerë të projekteve
- Sekretariatit pranë ministrive të linjës.

## Informimi

Kjo është një nismë e rëndësishme. Përdorimi i buxhetit për ta çuar përpara barazinë gjinore do të ketë rezultate të ndjeshme pozitive. Përfshirja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve si një mjet për çuarjen përpara të barazisë gjinore do të sjellë përfitime të tjera shtesë, jo vetëm sa u takon përfituesve të projekteve, por edhe sa i takon rritjes së ndërgjegjësimit për barazinë gjinore të një grupi të gjerë të grupeve të interesit.

Mirë është të përfshihet shoqëria civile në një fushatë informimi për VKM-në në lidhje me FZHR-në. Idealja do të ishte që njësive të pushtetit vendor t'u jepen burimet (financiare dhe në formën e ekspertëve të çështjeve gjinore) për nisjen e një fushate të tillë.



## Dokumentimi

Të identifikohet i gjithë dokumentacioni i lidhur me FZHR dhe të rishikohet lidhur me kriteret gjinore

- Udhëzimi i MF-së për buxhetin
- Udhëzuesi i Komitetit për procesin e miratimit
- Udhëzuesi i Sekretariatit për procesin e vlerësimit
- Parametrat e raporteve të Sekretariatit të Përgjithshëm për Komitetin
- Parametrat e raporteve të Komitetit për Këshillin e Ministrave
- Udhëzuesit e ministrive të linjës për njësitë e qeverisjes vendore për përgatitjen e propozimeve të projekteve
- Informacioni për publikun

Të sigurohet që dokumentacioni i kërkesave për projekte të përfshijë hapësirën dhe këshillat e duhura për paraqitjen e të dhënave

Të sigurohet që të dhënat për shpenzimet publike për barazinë gjinore përmes Fondit të dokumentohen në funksion të buxhetit

## Administrimi

Kjo është një masë e rëndësishme. Kjo masë përfshin një sërë subjektsh dhe një gamë personash. Ka potencial për një efekt të konsiderueshëm mbi barazinë gjinore.

Ka një zinxhir të kalimit të informacionit dhe të vendimmarrjes që ka nevojë për kontroll mbikëqyrës. Për rrjedhojë, është e rëndësishme që një personi t'i ngarkohet përgjegjësia e përgjithshme e administrimit.





A large, stylized yellow number '5' is the central graphic element, set against a light gray background. The number is composed of several thick, yellow geometric shapes that form its outline and internal structure. The top bar is a horizontal rectangle, the vertical stem is a vertical rectangle, and the bottom hook is a large, curved shape that loops back to the left. The number is positioned centrally, with the text 'Kërkesa 5 e VKM-së' overlaid on it.

# Kërkesa 5 e VKM-së

**Harmonizimi i BPGJ-së  
me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore**

Në zbatim të pikës 5 të VKM Nr.465, datë 18.07.2012 “ Për Integrimin gjinor në Programin buxhetor afatmesëm”, ministritë e linjës duhet të përcaktojnë programet buxhetore për të cilat do të zbatohet integrimi gjinor në buxhetim mbështetur në objektivat e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015. Kjo strategji ka përcaktuar 4 përparësi strategjike me qëllimet dhe objektivat specifike si më poshtë:

### **Forcimi i Mekanizmit Institucional dhe Ligjor për të nxitur përparimin e barazisë gjinore përmes**

- Përmirësimin të Mekanizmit Shtetëror në nivel qendror dhe vendor
- Rishikimin të legjislacionit shqiptar nga këndvështrimi gjinor në përputhje me dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit
- Rritjes së kapaciteteve e autoriteteve qendrore dhe vendore për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe strategjisë për barazinë gjinore në Shqipëri

### **Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, përmes:**

- Sigurimit të aksesit dhe pjesëmarrjes së plotë të vajzave dhe grave në politikë
- Rritjes së shkallës së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje të paktën deri në 30% në të gjithë sektorët vendimmarrës
- Rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në forcat/misionet paqeruajtëse dhe në strukturat e policisë
- Rritjes së aftësisë së grave si qytetare për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe drejtim.



### **Fuqizimi ekonomik dhe shoqëror i grave dhe burrave nëpërmjet adresimit të pabarazive gjinore që çojnë në varfëri dhe promovimit të përfshirjes sociale përmes :**

- Rritjes së pavarësisë ekonomike e grave duke shtuar dhe përmirësuar aksesin në kreditim, si dhe programeve dhe strukturave mbështetëse për kujdes dhe mbrojtje shoqërore.
- Nxitjes së formimit profesional dhe punësimit të grave dhe vajzave
- Zgjerimit të programeve për punësimin e grave dhe vajzave.

### **Eliminimi i dhunës me bazë gjinore përmes:**

- Ashpërsimit të dënimit të dhunës nëpërmjet një kuadri ligjor me tolerancë zero ndaj dhunës me bazë gjinore.
- Ndërgjegjësimin të vazhdueshëm në çdo hallkë të shoqërisë shqiptare për parandalimin e dhunës me bazë gjinore
- Mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e dhunës dhe dhunuesit me anë të shërbimeve për rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës
- Ngritjes së kapaciteteve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor për çështjet e dhunës me bazë gjinore

Strategjia shoqërohet nga Plani i detajuar i veprimit në të cilën janë përcaktuar qëllimet dhe objektivat strategjike, ndërhyrjet e nevojshme, lidhjet me strategjitë e tjera sektoriale, institucionet përgjegjëse për realizimin e këtyre ndërhyrjeve, treguesit përkatës për të gjitha fushat prioritare të sipërpërmendura dhe burimet e mbledhjes së tyre.

Ministritë (së bashku me institucionet e tyre vartëse) të përfshira në këtë strategji janë MPCSSHB, MASH, MSH, MB, MD, MM, METE, MF dhe MBUMK. Këto ministri identifikojnë programet buxhetore që lidhen me objektivat strategjike të përcaktuar në planin e veprimit dhe përfshijnë objektivat gjinorë, produktet dhe aktivitetet sipas



procedurave standarde të përcaktuara në udhëzimin nr.8 , datë 29.03.2012 “ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm “.

Ministritë e linjës duhet të sigurohen që të përfshijnë nëpunësin gjinor në ekipet e menaxhimit të programeve për të cilat do të përcaktohen objektivat gjinore. Një grup pune ndër ministror i udhëhequr nga MPCSSHB( DPSHF), në përberjen e të cilit ka përfaqësues nga të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e SKBGJ-DHBGJ 2011-2015, duhet koordinojë të gjithë procesin e buxhetimit dhe monitorimit të objektivave gjinorë në PBA.





# Kërkesa 6 e VKM-së

**Përgjegjësia e ministrive  
lidhur me zbatimin e Vendimit**

## Përgjegjësitë e përcaktuara

Ky VKM është propozim i përbashkët i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) dhe Ministrisë së Financave (MF). Si i tillë, përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e Vendimit e kanë këto ministri. Ministria tjetër e ngarkuar me këtë përgjegjësi është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK).

Përgjegjësitë e përcaktuara në vendim janë:

- MPÇSSHB ka përgjegjësinë të këshillojë të gjitha ministritë për vendosjen e programeve buxhetore me integrim gjinor
- MF dhe MPÇSSHB kanë bashkërisht përgjegjësinë të nxjerrin një udhëzim për procedurën e zbatimit të Vendimit
- MPÇSSHB dhe MBUMK kanë detyrimin të fillojnë integrimin gjinor në përgatitjet aktuale të buxhetit
- Vendimi është i detyrueshëm për të gjitha ministritë duke filluar nga viti 2013, çka do të thotë se të gjitha ministritë duhet të identifikojnë objektivat e barazisë gjinore brenda një ose dy prej programeve të tyre.

## Struktura e Menaxhimit


Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor bashkon dy grupe informacionesh të cilat normalisht mbahen më vete: informacionet për barazinë gjinore dhe informacionet për buxhetin. Kjo ndërthurje kërkon një organizim menaxhimi të ndërthurur.

Organizimi dhe administrimi i procesit të PBA-së është i përcaktuar shumë qartë. Ka një paketë të përcaktuar procedurash, një strukturë të qartë menaxhimi dhe një metodikë të hollësishme e të dokumentuar.

Diagrami i mëposhtëm ilustron Strukturën e Menaxhimit, ndërsa në rubrikën 4 “Përcaktimin e objektivave gjinorë në programet buxhetore” trajtohen procedurat që duhen ndjekur.



## Struktura e Menaxhimit e PBA-së



## Mekanizmi i barazisë gjinore

Termi mekanizëm gjinor ka të bëjë me strukturat zyrtare shtetërore të cilave u është ngarkuar detyra për nxitjen e barazisë gjinore dhe/ose përmirësimin e statusit dhe të drejtave të grave. Platforma për Veprim e Pekinit (PVP) thekson rëndësinë e pasjes së këtyre strukturave. Ato mund të ngrihen me ligj, me vendim qeverie ose me akte të tjera zyrtare. Disa vëzhgues besojnë se, për të qenë e efektshme, mekanizmi i barazisë gjinore duhet të jetë një agjenci e ngritur me ligj, e centralizuar dhe me fonde të mjaftueshme.

Në Shqipëri, mekanizmi i barazisë gjinore përbëhet nga këto subjekte:

- Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ)
- Ministri i Shanseve të Barabarta (MPCSSHB)
- MÇSSHB - Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes (DPSHBF)
- Grupi Ndërmintor i Punës për Monitorimin e Barazisë Gjinore në Shqipëri
- Nëpunësi gjinor në çdo ministri dhe organ vendor (vetëm MM, METE, MSH, MD, MBUMK dhe Policia e Shtetit me kohë të plotë, ministritë e tjera kanë pikat e kontaktit për çështjet gjinore)
- Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, përfshi dhe nën komisionin për Barazinë Gjinore.
- Komisioneri i Anti-Diskriminimit - për të gjitha shkaqet e diskriminimit
- Avokati i Popullit

Çfarë bie në sy, edhe pse jo e pazakontë, është mungesa e shpjegimit me hollësi të mënyrës me të cilën punojnë bashkë këto subjekte, si ndërveprojnë, pra si funksionon në të vërtetë kjo makineri. Kjo dallon nga përshkrimi shumë i hollësishëm i mënyrës me të cilën funksionon “makineria” e PBA-së.

Detyra në lidhje me VKM-në është:

- Caktimi i hapave të veprimeve për integrimin e çështjeve gjinore në procesin buxhetor



- Plotësimi i strukturës së menaxhimit të PBA-së me njohuri adekuatë prej eksperti për çështjet gjinore dhe
- Sigurimi i përfshirjes së mekanizmit të barazisë gjinore.

Objektivi që qëndron pas kësaj liste të gjithanshme detyrash është sigurimi i angazhimit të mbarë qeverisë për vënien në zbatim të këtij VKM-e. Arritja e një integrimi të vërtetë gjinor përmes futjes së tij në qendër të procesit të PBA-së dhe futja e makinerisë gjinore në administrimin e kësaj mase tejet të rëndësishme të barazisë gjinore dhe masës po aq të rëndësishme të reformës buxhetore.

### Grupi Drejtues

Në tabelën më poshtë përshkruhen detyrat që duhet të kryejnë ministrinë e veçanta të linjës, subjektet e makinerisë gjinore dhe grupet e tjera përkatëse të interesit.

Mbi këtë, duhet të qëndrojë një grup drejtimi ndërdepartamental, detyra e të cilit duhet të jetë bashkërendimi i të gjithë punës. Rekomandohet që në këtë grup drejtues të përfaqësohen sa më shumë ministri të linjës. Në këtë mënyrë, ministrinë që do të bëjnë integrimin gjinor në vitin 2013 mund të mësojnë që në këtë raund të parë buxheti.

MF

- Qarkorja/Udhëzimi i buxhetit lidhur me përmbajtjen e VKM-së 465
- Shqyrton dokumentacionin/udhëzuesit dhe inkorporon udhëzimin për VKM 465
- Miraton Udhëzimin për VKM 465
- Shpërndan Udhëzimin tek të gjitha grupet e interesit të PBA-së



### MPÇSSHB

- Ua komunikon përmbajtjen e VKM-së 465 subjekteve të makinerisë gjinore
- Përpilon rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme të Grupit për Menaxhimin Strategjik
- Miraton Udhëzimin për VKM 465
- Shpërndan Udhëzimin tek të gjitha grupet e interesit të Makinerisë Gjinore

### Ministritë e linjës

- E shpërndajnë gjerësisht qarkoren/udhëzimin e buxhetit
- Përpilojnë rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme të Grupit për Menaxhimin Strategjik
- Udhëzojnë ekipet e menaxhimit të programeve lidhur me VKM 465
- Caktojnë përgjegjësitë për raportimin

### Ministria e Brendshme

- Ngre strukturën drejtuese për Kërkesën 3 të VKM-së për Fondet e Zhvillimit Rajonal
- Siguron shpërndarjen e VKM-së 465 tek të gjithë anëtarët e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe të gjitha njësitë e pushtetit vendor
- Ngre grupin e punës me MF-në dhe MPÇSSHB-në për përcaktimin e kriterëve gjinorë



### Grupi për Menaxhimin Strategjik

- Siguron që VKM 465 njihet dhe kuptohet nga i gjithë personeli
- Në fazën pilot siguron shqyrtimin e rregullt të statusit të vënies në zbatim të kërkesës 4 të VKM-së

### Ekipet e Menaxhimit të Programeve

- Ngrënë mekanizmin për zhvillimin e objektivit të barazisë gjinore – grupi i punës siguron ndërlidhjen me ekspertizën përkatëse gjinore
- Caktojnë përgjegjësinë për punën e përditshme

### Këshilli i Ministrave

- Komunikon për planet e zbatimit të VKM-së 465 me të gjitha palët përkatëse të interesit, ku përfshihen, ndër të tjera, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore, Ministria e Integrimit, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, anëtarët e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, Kuvendi



Këshilli  
Kombëtar  
i Barazisë  
Gjinore

- Siguron që VKM 465 njihet dhe kuptohet nga i gjithë personeli
- Në fazën pilot siguron shqyrtimin e rregullt të statusit të vënies në zbatim të kërkesës 4 të VKM-së

Departamenti i  
Bashkërendimit  
të Strategjive dhe  
Koordinimit të  
Ndihmës së Huaj

- Ngre mekanizmin për zhvillimin e objektivit të barazisë gjinore – grupi i punës siguron ndërlidhjen me ekspertizën përkatëse gjinore
- Cakton përgjegjësinë për punën e përditshme





# Kërkesa 7 e VKM-së

**Çuarja përpara  
e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në PBA**

## Vënia e hershme në zbatim

Në rastin e parë, pra në këtë fazë të menjëhershme në vijim të PBA-së, Vendimi kërkon që dy ministri (Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK)) të integrojnë çështjet gjinore në buxhetim. Konkretisht, Vendimi kërkon futjen e të paktën një objekti gjinor në një ose dy programe buxhetore.



# Shtoto

Shtojca 1: Shembuj të integritit gjinor në disa programe buxhetore të MPCSSHB dhe MBUMK 2014-2016.

Shtojca 2: Disa shembuj të lidhjes së objektivave të SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 me programet buxhetore të ministrive të linjës

gjicaat

Shtojca 3: Shembuj ndërkombëtarë të  
buxhetimit të përgjigjshëm gjinor

# Shtojca

## **Shtojca 1: Shembuj të integritit gjinor në disa programe buxhetore të MPCSSHB dhe MBUMK 2014-2016.**

Në bazë të Udhëzimit nr.9, datë 22.02.2013 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016” të Ministrit të Financave gjatë vitit 2013 u pilotuan disa programe buxhetore të MPCSSHB dhe MBUMK.

Udhëzimi nr.9, datë 22.02.2013 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016”

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

### **UDHËZIM**

Nr.9, Datë 22.02.2013

PËR

### **“PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2014-2016”**

Në përputhje me Nenin 24 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikës 67 të Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Ministri i Financave:

U D H Ë Z O N:

1. Të përgjithshme

- Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi i Njësive të Qeverisjes Qendrore mbi

I

tavanet e shpenzimeve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 20.02.2013 “Për miratimin tavanëve të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, si dhe afatet kohore për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave buxhetore afatmesme 2014-2016, afate të cilat janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.909, datë 19.12.2012 “Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2013”.

- Për procedura të detajuara mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore, njësitë e qeverisjes qendrore duhet t’i referohen përcaktimeve të Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
- Njësitë e Qeverisjes Qendrore, nëpërmjet sistemit informatik të Programit Buxhetor Afatmesëm, hartojnë kërkesat e tyre buxhetore. Aksesi në këtë software bëhet i mundur nëpërmjet GOVNET. Për institucionet që kanë mungesë aksesi në GOVNET, kërkesat buxhetore do të paraqiten nëpërmjet formateve standarte në EXCEL, të paraqitura në Shtojcën nr.1, të udhëzimit përkatës.

## 2. Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016

- Deklarata e Politikës së Programit 2014-2016, e përgatitur nga çdo njësi e Qeverisjes Qendrore, duhet të jetë domosdoshmërisht në përputhje të plotë me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara paraprakisht prej tyre në Dokumentin Strategjik të hartuar së fundi, në kuadër të rishikimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020.
- Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 18.07.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës duhet përcaktojnë tregues të përshtatshëm dhe të matshëm për barazinë gjinorë, brenda një ose dy programeve buxhetore përkatëse.
- Tavanet Përgatitore të PBA 2014-2016 për Njësitë e Qeverisjes Qendrore, të miratuara me anë të VKM nr.138, datë 20.02.2013 “Për miratimin e tavanëve të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, jepen në Tabelen nr.1 që shoqëron këtë Udhëzim.



# Shtetshini

- Kërkesat buxhetore duhet të jenë detyrimisht brenda këtyre taveve të miratuara.
- Për planifikimin e investimeve të programit, njësitë e qeverisjes qendrore duhet t'i referohen formularëve përkatës në Shtojcat 2A, 2A1 dhe 2B, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.
- Në rastet kur tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm nuk përmbushin nevojat më të domosdoshme, Njësitë e Qeverisjes Qendrore mund të paraqesin Kërkesa Shtesë sipas procedurës përkatëse të ilustruar në Shtojcën nr.5, të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
- Kurset e Këmbimit për vitet 2008-2013 dhe parashikimi për vitet 2014-2016, që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	V.2008	V.2009	V.2010	V.2011	V.2012	V.2013	V.2014	V.2015	V.2016
1	Kurs i këmbimit mesatar lek/ USD	83.9	95	103.9	100.9	109.5	109.5	109.7	109.0	108.0
2	Kurs i këmbimit mesatar lek/ EURO	122.8	131.6	137.7	140.5	139.0	139.9	139.5	140.0	140.4

### 3. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016

- Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2013, të detyrueshme për t'u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:
  - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 për **Fazën I, është deri më datë 01 maj 2013**;
  - Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit, duhet të shpërndahej tek

Njesitë e Qeverisjes Qendrore pas miratimit të draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 nga Këshilli i Ministrave, brenda datës **10 korrik 2013**.

- Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 për **Fazën II, është deri më datë 30 gusht 2013**.
  - Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016, për **Fazat I dhe II**, paraqiten në Tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Përkatësisht në periudhat **20 - 31 maj 2013** dhe **16 - 27 shtator 2013**, Ministria e Financave do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njesive të Qeverisjes Qendrore, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 të dërguara prej tyre si dhe do të jepen rekomandimet përkatëse nga ana e Ministrisë së Financave. Rekomandimet përfundimtare do të jenë pjesë e Draftit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 që do të dërgohet në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe në Këshillin e Ministrave si edhe, duhet të mbahen në konsideratë nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore gjatë Fazës II të rishikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016.
  - Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” do të zbatohen për nëpunësit autorizues, në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.
4. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 dhe Mbështetja Këshillimore
- Ministria e Financave do të organizojë në ambientet e saj takime me të gjithë Nëpunësit Autorizues të Njësive të Qeverisjes Qendrore për të diskutuar progresin dhe shqetësimet që mund të lindin gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Këto takime do të organizohen përkatësisht në datat:
    - *Takimi i parë, ditën e Enjte, datë 21 mars 2013, ora 11:00*
    - *Takimi i dyte, ditën e Premte, datë 19 prill 2013, ora 11:00*



# Shtetërimi

- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri i këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do raportohet rregullisht nga Ministri i Financave tek Komiteti i Planifikimit Strategjik, dhe Këshilli i Ministrave.
- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016, vë në dispozicion për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore adresën email: [budget.programming@minfin.gov.al](mailto:budget.programming@minfin.gov.al).
- DEBASKON, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e SKZHI 2013-2020, vë në dispozicion për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore buxhetor adresën email: [koordinimi@km.gov.al](mailto:koordinimi@km.gov.al)

RIDVAN BODE  
MINISTER



# I

## I. Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Programi” Mbrojtja Sociale”

### Hapat për përcaktimin e objektivave për barazinë gjinore

1. Identifikimi i programeve specifike ku mund të integrohen objektivat gjinorë .

Në fazën e rishikimit të politikës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon programin dhe punën e programit e cila përcaktohet në përshkrimin e programit :

Programi i Mbrojtjes Sociale mbështet nëpërmjet pagesave në kesh me ndihmë ekonomike dhe shërbime shoqërore, familjet dhe individët në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, rruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, psikologjike e shoqërore.

2. Identifikimi i pabarazive gjinore – burimet e të dhënave. Mbas përcaktimit të punës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon pabarazinë gjinore që ekziston brenda programit në bazë të analizës dhe burimeve të të dhënave:

Sipas të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror, aktualisht në skemën e ndihmës ekonomike trajtohen rreth 101 747 familje, nga të cilat: 69 293 familje marrin ndihmë të pjesshme, ndërsa 32 454 familje e përfitojnë të plotë. Nga këto, 11 623 familje ose 11.4% e numrit të përgjithshëm të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike kanë si kryefamiljar një grua<sup>4</sup>.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2012, numri i familjeve që kanë përfituar pagesën e ndihmës ekonomike rezulton 99 715 familje me një fond prej 5.473.604 mijë lekë<sup>5</sup>. Gratë kryefamiljare që trajtohen me ndihmë ekonomike kanë përfituar 396,385 mijë lekë ose vetëm 7.25% të fondit të përgjithshëm për pagesën e ndihmës ekonomike.

.....

<sup>4</sup> <http://www.77news.al/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=19892>

<sup>5</sup> Raporti i Monitorimit viti 2012 (Në vlerën prej 5.473.604 lekë, përveç vlerës që marrin familjet që trajtohen me NE, është përfshirë dhe kostoje e shpenzimeve për paga e shpenzime operative të personelit që punojnë për këtë program).



# Shtetëri

### 3. Përcaktimi i prioriteteve për barazinë gjinore në deklaratën e politikës së programit ( përshkrimin e politikës së programit / qëllimin e politikës)

Politika e programit. Politikat që do të ndiqen në kuadër të këtij programi fokusohen në mbrojtjen e grupeve në nevojë nga varfëria dhe përjashtimi social duke siguruar akses të barabartë në sistemin e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta për individin (grua apo burrë ) dhe familjen. Zgjerimi, përmirësimi dhe mbulimi me llojshmëri shërbimesh, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individët (gra dhe burra), familjet, grupimet dhe komunitetet të vetë-funksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë në zhvillimet shoqërore.

#### Qëllimi i politikës pa përfshirë kriterin gjinor

Nëpërmjet politikave të mbrojtjes sociale synohet i) 15% e familjeve/individët në nevojë synohet të dalin nga program i ndihmës ekonomike, të dalin nga pragu i varfërisë deri në vitin 2016; 21% fëmijë në nevojë, 28% fëmijë me aftësi të kufizuara, 50% viktimave të trafikimit, 90% viktimat të dhunës dhe 21% të moshuar në nevojë, do të mbështeten më shumë me shërbime të përkujdeit shoqëror deri në vitin 2015 krahasur me vitin 2012. Mbështetja e nevojave të personave me aftësi të kufizuara me pagesa dhe shërbime në përputhje me nevojat e tyre. Mbështetja e të përndjekurve politik duke gëzuar ndihmën e nevojshme financiare të përkujdesit të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat njësoj si të tjerët.

#### Qëllimi i politikës përfshirë kriterin gjinor

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë grupet në nevojë për të plotësuar nevojat baze jetike, duke siguruar akses të barabartë për burrat dhe gratë. Nëpërmjet politikave të mbrojtjes sociale synohet i) 15% e familjeve/individëve në nevojë synohet të dalin nga program i ndihmës ekonomike, të dalin nga pragu i varfërisë deri në vitin 2016; 21% fëmijë në nevojë, 28% fëmijë me aftësi të kufizuara, 50% viktimave të trafikimit, 90% viktimat dhunës dhe 21% të moshuar në nevojë, do të mbështeten më shumë me shërbime të përkujdeit shoqëror deri në vitin 2015 krahasur me vitin 2012. Mbështetja e nevojave të personave me aftësi të kufizuara me pagesa dhe shërbime në përputhje me nevojat e tyre. Mbështetja e të përndjekurve politikë duke gëzuar ndihmën e nevojshme financiare të përkujdesit të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat njësoj si të tjerët.

#### 4. Përcaktimi i objektivave për barazinë gjinore

##### Objektivi pa përfshirë kriterin gjinor

Objektivi : Zbutja e varfërisë nëpërmjet: 2014- Ulja e numrit të familjeve nga skema e NE 3000 familje. 2015- Zbutja e varfërisë nëpërmjet uljes së numrit të familjeve nga skema e NE me 3500 familje. 2016- Zbutja e varfërisë nëpërmjet uljes së numrit të familjeve nga skema e NE me 3000 familje.

##### Objektivi përfshirë kriterin gjinor

Objektivi : Zbutja e varfërisë nëpërmjet: 2014- Uljes së numrit të familjeve nga skema e NE 3381 familje, nga të cilat 90 me kryefamiljare gra .v.2015- uljes së numrit të familjeve nga skema e NE me 4000 familje, nga të cilat 100 me kryefamiljare gra .v.2016- uljes së numrit të familjeve nga skema e NE me 5000 familje, nga të cilat 115 me kryefamiljare gra.

#### 5. Shqyrtimi dhe modifikimi i produkteve dhe aktiviteteve ekzistuese për të arritur objektivat gjinore .Nëse është nevoja, përcaktimi i produkteve dhe aktiviteteve të reja.

##### Produkte pa përfshirë kriterin gjinor

A. Familje përfituese të ndihmës ekonomike

##### Produkte përfshirë kriterin gjinor

A. Familje përfituese të ndihmës ekonomike me kryefamiljarë burra

AA. Familje përfituese të ndihmës ekonomike me kryefamiljare gra



## 6. Llogaritja e kostos së produkteve dhe aktiviteteve

Produkte/ Vitet	2014		2015		2016	
	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve
A. Familje përfituese të ndihmës ekonomike me kryefamiljarë burra	86,090 familje	3,905,042 mijë lekë	82,190 familje	3,888,409 mijë lekë	77,305 familje	4,128,860 mijë lekë
AA. Familje përfituese të ndihmës ekonomike me kryefamiljare femra	10,910 familje	494,878 mijë lekë	10,810 familje	511,421 mijë lekë	10,695 familje	571,220 mijë lekë

## 7. Përcaktimi i strukturës së menaxhimit: Drejtoria e Politikave të Shërbimeve

## **II. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Programi” Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”**

### **Hapat për përcaktimin e objektivave për barazinë gjinore**

1. Identifikimi i programeve specifike ku mund të integrohen objektivat gjinorë .

Në fazën e rishikimit të politikës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon programin dhe punën e programit e cila përcaktohet në përshkrimin e programit :

Programi Këshillimi dhe informacioni bujqësor përfshin realizimin e politikave të MBUMK-se, për zhvillimin e bujqësisë , duke asistuar fermerët me metoda dhe materiale të reja (inpute) për bujqësinë; paketa/karta teknologjike (elementë të përmirësura ) për kultura bujqësore dhe blegtorale, hallka të larta të disa lloje farërash e fidanësh të çertifikuara; trajnimin e specialistëve të bujqësisë; publikime dhe mjete të tjera të komunikimit masiv; promovimin e kooperimit bujqësor, promovimin dhe mbështetjen e barazise gjinore

2. Identifikimi i pabarazive gjinore – burimet e të dhënave. Mbas përcaktimit të punës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon pabarazinë gjinore që ekziston brenda programit në bazë të analizës dhe burimeve të të dhënave.

Pabarazitë gjinore brenda programit lidhen me faktin që aksesin në shërbimet e ofrouara nga ky program e kanë rreth 95% burra fermerë dhe vetëm 5% gra fermere. Te dhënat janë raportuar nga përgjësit e programit por nderkohë nuk ekzistojnë të dhëna të ndara sipas seksit të përfituesve të shërbimeve. Sipas studimit të verësimit të programit këshillim dhe informacion bujqësor të ndërmarrë nga MBUMK me mbështetjen e UN Women rezulton se gratë fermere nuk janë në dijeni as të llojeve të shërbimeve që ofrohen dhe shumë pak prej tyre arrijnë të përfitojnë ndonjë shërbim.

3. Përcaktimi i prioriteteve për barazinë gjinore në deklaratën e politikës së programit (përshkrimin e politikës së programit / qëllimin e politikës)



# Shfiri

Qëllimi i politikës pa përfshirë kriterin gjinor

Rritja e aftësisë konkurruese të fermave nëpërmjet: Ofrimit të rreth 120 paketave/ teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe rreth 25 studime kombëtare dhe rajonale, (deri në vitin 2020), sigurimit të aksesit për informacion dhe njohuri të reja në fushën e bujqësisë e blegtorisë, bazuar në një strategji efektive të komunikimit

Qëllimi i politikës përfshirë kriterin gjinor

Rritja e aftësisë konkurruese të fermave të drejtuara nga burrat dhe gratë nëpërmjet : Ofrimit të rreth 120 paketave/ teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe rreth 25 studime kombëtare dhe rajonale, (deri në vitin 2020), sigurimit të aksesit për informacion dhe njohuri të reja në fushën e bujqësisë e blegtorisë, bazuar në një strategji efektive të komunikimit .

## 4. Përcaktimi i objektivave për barazinë gjinore

Objektivi pa përfshirë kriterin gjinor

Objektivi viti 2014- Sigurimi i aksesit për informacion, nëpërmjet strukturës së shërbimit këshillimor, për 70 mijë fermerë dhe agrobiznese; viti 2015- Sigurimi i aksesit për informacion, nëpërmjet strukturës së shërbimit këshillimor, për 68 mijë fermerë dhe agrobiznese; viti 2016- Sigurimi i aksesit për informacion, nëpërmjet strukturës së shërbimit këshillimor, për 68 mijë fermerë dhe agrobiznese.

Objektivi përfshirë kriterin gjinor

Objektivi viti 2014- Sigurimi i aksesit për informacion, nëpërmjet strukturës së shërbimit këshillimor, për 70 mijë fermerë dhe agrobiznese, prej të cilëve 7700 fermerë ose 11% e tyre të jenë gra, viti 2015-për 68 mijë fermerë dhe agrobiznese, prej të cilëve 10 200 fermerë ose 15% e tyre të jenë gra, viti 2016 - për 68 mijë fermerë dhe agrobiznese, prej të cilëve 13 600 fermerë ose 20% e tyre të jenë gra

## 5. Shqyrtimi dhe modifikimi i produkteve dhe aktiviteteve ekzistuese për të arritur objektivat gjinore. Nëse është nevoja, përcaktimi i produkteve dhe aktiviteteve të reja.

Produkte pa përfshirë kriterin gjinor

G.Fermerë të kontaktuar dhe ofrim shërbimesh ekstensiononi

Produkte përfshirë kriterin gjinor

G.Fermer djem/burra të kontaktuar dhe ofrim shërbimesh ekstensiononi

H.Fermer vajza/gra të kontaktuar dhe ofrim shërbimesh ekstensiononi

## 6. Llogaritja e kostos së produkteve dhe aktiviteteve

Produkte/Vitet	2014		2015		2016	
	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve
Fermer djem/burra të kontaktuar dhe ofrim shërbimesh ekstensionit	62,300 fermerë	46,102 mijë lekë	57,800 fermerë	46,662 mijë lekë	54,400 fermerë	44,064 mijë lekë
Fermer vajza/gra të kontaktuar dhe ofrim shërbimesh ekstensionit	7,700 fermere	5,698 mijë lekë	10,200 fermere	8,058 mijë lekë	13,600 fermere	11,016 mijë lekë

## 7. Përcaktimi i strukturës së menaxhimit. Drejtoria e Këshillimit dhe Informacionit Bujqësor



### **III. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Programi” Zhvillimi Rural duke mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrinë dhe Marketimin”**

#### **Hapat për përcaktimin e objektivave për barazinë gjinore**

1. Identifikimi i programeve specifike ku mund të integrohen objektivat gjinorë .

Në fazën e rishikimit të politikës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon programin dhe punën e programit e cila përcaktohet në përshkrimin e programit :

Ky program fokusohet në drejtim të zhvillimit të sektorit bujqësor, përpunimit të produkteve bujqësore dhe tregtinë e tyre, por edhe me gjerë në zhvillimin e hapësirës rurale të vendit, edhe përmes masave që kapërcejnë drejtimet e mësipërme, si mbrojtja e burimeve prodhuese bujqësore dhe e mjedisit përmes politikave që nxisin zhvillimin ekonomik me perspektivën gjinore por që njëkohësisht janë miqësore edhe me mjedisin. Programi ka në fokus rritjen e prodhimit por edhe të prodhimtarisë së bimeve dhe kafsheve , të prodhimtarisë së punës bujqësore por edhe të efijçences ekonomike të sektorit bujqësor dhe agropërpunues. Përmbajtja e programit buron nga prioritetet zhvilluese të SSBU-së.

2. Identifikimi i pabarazive gjinore - burimet e të dhënave. Mbas përcaktimit të punës së programit ekipi i menaxhimit të programit identifikon pabarazinë gjinore që ekziston brenda programit në bazë të analizës dhe burimeve të të dhënave:

Pabarazia gjinore e adresuar brenda këtij programi lidhet me shpërndarjen e granteve për fermerët për t'i mbështetur ato në prodhimet e tyre bujqësore. Ndërkohë që vlerësimi i këtij programi nga këndvështrimi gjinor i ndërmarrë gjatë vitit 2012 nga Qendra për Studime të Avancuara mbështetur nga UN Women tregoi se nuk egzistojnë të dhëna të përfituesve të skemave mbështetëse të ndara sipas gjinisë së fermerit. Studimi u bazua edhe në intervista cilësore me punonjës të Agjencisë së Pagesave që menaxhon alokimin e granteve për fermerët. Nga ky studim rezultoi që numri i grave/vajzave fermere që aplikojnë për këto skema mbështetëse është pothuajse inegzisten dhe vetëm në rastet kur skema mbështet blegtorinë përqindja e grave/vajzave aplikuese dhe fituese të tyre mund të arrijë deri në 10% të përfituesve.

Kjo pabarazi prek edhe kriteret e vlerësimit të skemave mbështetëse sikurse dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

3. Përcaktimi i prioriteteve për barazinë gjinore në deklaratën e politikës së programit (përshkrimin e politikës së programit / qëllimin e politikës)

Politika e programit pa përfshirë kriterin gjinor.

Politikat që do të ndiqen në kuadrin e këtij programi fokusohen në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për rritjen e prodhimit nëpërmjet mbështetjes direkte të fermerëve për rritjen e prodhimit të frutave, rrushit, ullinjve, qumështit dhe mishit e cila do të aplikohet për një periudhë afatshkurtër dhe vazhdojnë me masat për përmirësimin e infrastruktures tregtare si tregje, magazina dhe mjedise frigoriferike. Masa të rëndësishme në kuadrin e politikës së programit përbëjnë dhe promovimi dhe nxitja e produkteve dhe teknologjive në bujqësi dhe agroindustri përmes aktiviteteve promovuese dhe informuese. Masa të tjera në kuadrin e programit janë ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së imputeve bujqësore si farera, fidanë, plehra kimike, etj, përmes përmirësimeve ligjore, investimeve direkte dhe forcimit të kapaciteteve përkatëse administruese

Politika e programit përfshirë kriterin gjinor.

Politikat që do të ndiqen në kuadrin e këtij programi fokusohen në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për rritjen e prodhimit nëpërmjet mbështetjes direkte të fermerëve gra dhe burra për rritjen e prodhimit të frutave, rrushit, ullinjve, qumështit dhe mishit e cila do të aplikohet për një periudhë afatshkurtër dhe vazhdojnë me masat për përmirësimin e infrastruktures tregtare si tregje, magazina dhe mjedise frigoriferike. Masa të rëndësishme në kuadrin e politikës së programit përbëjnë dhe promovimi dhe nxitja e produkteve dhe teknologjive në bujqësi dhe agroindustri përmes aktiviteteve promovuese dhe informuese. Masa të tjera në kuadrin e programit janë ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së imputeve bujqësore si farera, fidanë, plehra kimike, etj, përmes përmirësimeve ligjore, investimeve direkte dhe forcimit të kapaciteteve përkatëse administruese



# Shftirimi

## Qëllimi pa përfshirë kriterin gjinor

Të reduktojë varfërinë dhe të përmirësojë cilësinë e jetës në komunitetet rurale të Shqipërisë. Qëllimi themelor i politikës së programit është sigurimi i një mekanizmi për instrumentin e pre-aksesit në BE, në mënyrë që deri në vitin 2020 të ndodhë përafrimi i standarteve në bujqësi dhe marketingun bujqësor. Rritja e të ardhurave dhe mirëqënia e fermerëve dhe banorëve të tjerë të zonave rurale përmes rritjes së volumit të prodhimit bujqësor por jo vetëm. Politika e programit ka për qëllim gjithashtu të ndikojë në rritjen e specializimit në shkallë vendi (rajonizimi) dhe ferme për të rritur prodhimin dhe nxitur zhvillimin e tregtisë bujqësore. Rritja e shkallës së përpunimit industrial të produkteve bujqësore dhe blegtorale si dhe përmirësimi i marketingut të tyre është pjesë e pandarë e politikës së programit ashtu siç është pjesë dhe rritja e cilësisë, reduktimi i importeve dhe rritja e eksporteve të produkteve bujqësore shqiptare.

## Qëllimi përfshirë kriterin gjinor

Të reduktojë varfërinë dhe të përmirësojë cilësinë e jetës në komunitetet rurale të Shqipërisë. Qëllimi themelor i politikës së programit është sigurimi i një mekanizmi për instrumentin e pre-aksesit në BE, në mënyrë që deri në vitin 2020 të ndodhë përafrimi i standarteve në bujqësi dhe marketingun bujqësor. Rritja e të ardhurave dhe mirëqënia e fermerëve gra dhe burra dhe banorëve të tjerë të zonave rurale përmes rritjes së volumit të prodhimit bujqësor por jo vetëm. Politika e programit ka për qëllim gjithashtu të ndikojë në rritjen e specializimit në shkallë vendi (rajonizimi) dhe ferme për të rritur prodhimin dhe nxitur zhvillimin e tregtisë bujqësore. Rritja e shkallës së përpunimit industrial të produkteve bujqësore dhe blegtorale si dhe përmirësimi i marketingut të tyre është pjesë e pandarë e politikës së programit ashtu siç është pjesë dhe rritja e cilësisë, reduktimi i importeve dhe rritja e eksporteve të produkteve bujqësore shqiptare.



#### 4. Përcaktimi i objektivave për barazinë gjinore

Objektiva pa përfshirë kriterin gjinor

1). Nxitja e zhvillimit të qëndrueshem të sektorit bujqësor blegtoral dhe agroindustrisë me synim rritjen e prodhimit dhe konkurrueshmerisë së produkteve nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë të familjeve fermere dhe agrobizneseve; 2). Përmirësimi i infrastrukturës së marketingut dhe nxitja e biznesit privat.

Objektiva përfshirë kriterin gjinor

1). Nxitja e zhvillimit të qëndrueshem të sektorit bujqësor blegtoral dhe agroindustrisë me synim rritjen e prodhimit dhe konkurrueshmerisë së produkteve nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë të familjeve fermere të drejtuara nga gratë dhe burrat dhe agrobizneseve; 2). Përmirësimi i infrastrukturës së marketingut dhe nxitja e biznesit privat të drejtuar nga gratë dhe burrat;

5. Shqyrtimi dhe modifikimi i produkteve dhe aktiviteteve ekzistuese për të arritur objektivat gjinore. Nëse është nevoja, përcaktimi i produkteve dhe aktiviteteve të reja.

Produkte pa përfshirë kriterin gjinor

Rritja me 10% e sipërfaqes së mbjellë përmes skemave mbështetëse.

Produkte përfshirë kriterin gjinor

Rritja me 10% e përfituesve fermerë djem/ burra përmes skemave mbështetëse.

Rritja me 10% e përfituesve fermere vajza/gra përmes skemave mbështetëse.



# Shprehje

## 6. Llogaritja e koston së produkteve dhe aktiviteteteve

Produktet/Vitet	2014		2015		2016	
	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve	Sasia/ Produktet	Totali i shpenzimeve
E. Rritja me 10% e përfituesve fermerë djem/burra përmes skemave mbështetëse.	7,991	1,087,400 mijë lekë	8,790	1,091,500 mijë lekë	9,669	1,139,684 mijë lekë
EE. Rritja me 10% e përfituesve fermere vajza/gra përmes skemave mbështetëse.	798	108,609 mijë lekë	878	119,470 mijë lekë	966	131,417 mijë lekë

## 7. Përcaktimi i strukturës së menaxhimit .Drejtoria e Programimit të Politikave të Zhvillimit Rural



## Shtojca 2: Disa shembuj të lidhjes së objektivave të SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 me programet buxhetore të ministrive të linjës jepen si më poshtë:

Qëllimet / Objektivat  
SKBGJ-DHBGJ  
2011-2015

Programet  
buxhetore  
Ministritë e  
Linjës

Produktet

Tregues të  
rezultatit

Qëllimi Strategjik 1: Të fuqizohet Mekanizmi Institucional dhe Ligjor për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të të gjithë qytetarëve shqiptarë pa dallim përkatësie gjinore

Objektiv Specifik 1.2 Të rishikohet legjislacioni shqiptar nga këndvështrimi gjinor në përputhje me dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit

1.2.4 Të vazhdohet ndërgjegjësimi i opinionit publik sidomos i grave dhe vajzave për të drejtat ligjore që u takojnë (LBGJSH, LDHF, LMD)

Programi:  
Shanset e  
barabarta  
MPÇSSH

Numri i  
aktiviteteve  
informuese dhe  
ndërgjegjësuere  
Numri i  
pjesëmarrësve në  
aktivitete

Numri i grave dhe  
vajzave që nisin  
procese gjyqësore  
ose administrative  
ose administrative  
për të kërkuar  
të drejtat e  
tyre, si rezultat i  
ndërgjegjësimit

Qëllimi Strategjik 2: Të fuqizohen vajzat dhe gratë nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje.

Objektivi Specifik 2.1: Të merren masa për të siguruar aksesin dhe pjesëmarrjen e plotë të vajzave dhe grave në politikë

2.1.1 Të zhvillohen mekanizma dhe trainime për të inkurajuar gratë të marrin pjesë në procesin zgjedhor, aktivitete politike dhe fusha të tjera të udhëheqjes.

Programi:  
Shanset e  
barabarta  
MPCSSH

Numri i grave të  
trainuara

Përqindja e  
femrave dhe  
meshkujve (me  
të drejtë vote) që  
votojnë.



# Shtetshini

Objektiv Specifik 2.3: Të rritet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në forcat/misionet paqeruajtëse dhe në strukturat e policisë

2.3.1 Të aplikohen masa të veçanta pozitive duke synuar arritjen e përfaqësimit të barabartë (rreth 30%) të grave dhe vajzave në forcat/misionet paqeruajtëse dhe efektivat e policisë

Programi :  
Policia e Shtetit  
MB  
Programi: Forcat  
e luftimit MM

Numri dhe lloji i  
masave

Përqindja e vajzave  
dhe grave në  
forcat/misionet  
paqeruajtëse  
dhe strukturat e  
policisë

Qëllimi Strategjik 3: Të sigurohet fuqizimi ekonomik dhe shoqëror i femrave dhe meshkujve nëpërmjet adresimit të pabarazive gjinore që çojnë në varfëri dhe promovimit të përfshirjes sociale.

Objektiv Specifik 3.1: Të rritet pavarësia ekonomike e grave nëpërmjet shtimit dhe përmirësimit të aksesit në kreditim, programeve dhe strukturave mbështetëse për kujdes dhe mbrojtje shoqërore

3.1.1 Të mbështetet sipërmarrja e grave nëpërmjet hartimit të dhe zbatimit të kuadrit ligjor për dhënien e kredive të buta

Programi:  
Mbështetja  
për zhvillimin  
ekonomik  
METE

Kuadër ligjor i  
hartuar

Numri i fushatave  
ndërgjegjësuese


Përqindja e  
femrave dhe  
meshkujve që kanë  
qasje ndaj huave  
të biznesit dhe  
mikrokredive sipas  
vendndodhjes ( qytet -fshat)

3.1.2 Të krijohet një Fond i Veçantë për nxitjen e sipërmarrjes së grave, dhe të bëhen aktivitete ndërgjegjësuese në lidhje me përdorimin e këtij fondi

Programi:  
Mbështetja  
për zhvillimin  
ekonomik  
METE

Fondi i krijuar  
Numri i  
aktiviteteve  
ndërgjegjësuese

% e grave  
sipërmarrëse që  
përdorin këtë fond  
ndaj totalit të  
grave sipërmarrëse



3.1.11 Të mundësohet akses i grave rurale në pronë dhe në asete të tjera si pyjet, burimet natyrore nëpërmjet rregullimit të kuadrit ligjor për pronën dhe të bëhen aktivitete ndërgjegjësuere në lidhje me këtë kuadër ligjor.

Programi:  
Shërbimi i  
Regjistrimit të  
Pasurive të  
Paluajtshme  
MD  
Programi:  
Zhvillimi rural  
MBUMK

Kuadri ligjor  
ndryshuar  
(numri i ligjeve të  
ndryshuara)  
Numri i  
aktiviteteve  
ndërgjegjësuere/  
materialeve të  
prodhuara dhe  
shpërndara

Përqindja e  
femrave në  
fshat që janë të  
rregjistruara dhe  
zotërojnë pronë  
dhe asete

3.1.12 Të monitorohet zbatimi i të drejtës së pronësisë për gratë, veçanërisht ato në zonat rurale

Programi:  
Shërbimi i  
Regjistrimit të  
Pasurive të  
Paluajtshme  
MD  
Programi:  
Zhvillimi Rural  
MBUMK

Numri i  
vendimeve  
gjyqësore të  
monitoruara

Përqindja e grave  
që përfitojnë të  
drejtën e pronësisë  
nëpërmjet  
vendimeve  
gjyqësore  
krahasuar me  
rastet e çuara në  
Gjykatë

Qëllimi Strategjik 4: Të rritet ndërgjegjësimi ndaj dukurisë së dhunës me bazë gjinore, mbrojtja ligjore dhe administrative, si dhe mbështetja me shërbime për viktimat e dhunës dhe dhunuesit.

Objektivi specifik 4.3 Të mbrohen dhe të mbështeten viktimat e dhunës dhe dhunuesit nëpërmjet shërbimeve dhe riintegrimin e viktimave

4.3.10 Të bëhen trainime për rritjen e aftësive dhe shërbimet mikrofinanciare për fuqizimin ekonomik të grave viktimave/mbijetuesve të dhunës

Programi:  
Mbrojtja Sociale  
(MPCSSHB)

Numri i grave  
viktimave të dhunës  
që marrin pjesë  
në programet e  
trainimit

Numri i grave  
viktimave të dhunës  
që përdorin  
shërbimet  
mikrofinanciare



# Shtetshini

## Shtojca 3: Shembuj ndërkombëtarë të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor

### Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në Australi

Australia është vendi i parë që ka përdorur buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, në vitin 1984. Kjo ka qenë dhe vazhdon të jetë një nismë e udhëhequr nga qeveria. Gjatë viteve '80 dhe '90 të shekullit XX, ky proces u zgjerua për të përfshirë të gjitha buxhetet në nivel federal, shtetëror dhe territorial. Rezultatet e analizave janë botuar si Pasqyrat Buxhetore të Grave dhe janë bërë pjesë e dokumentacionit buxhetor zyrtar që i paraqitet për diskutim parlamentit. Edhe pse procesi zyrtar i analizës buxhetore gjinore nuk bëhet më, një formë e pasqyrës buxhetore të grave ende botohet në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Qasja e ndjekur në Australi ka si objektiv parësor integrimin gjinor. Krijimi i Zyrës për Statusin e Grave pranë Departamentit të Kryeministrit dhe Kabinetit ka mundësuar një ndikim në nivel të lartë në vendimet e marra në këto nivele të larta lidhur me programet dhe buxhetet.

Analiza është mbështetur në dallimin e mëposhtëm ndërmjet tre llojeve të ndryshme të shpenzimeve:

- Shpenzimet buxhetore për programet e caktuara, për të korrigjuar çekuilibrin e identifikuar gjinor që i vendos gratë në pozita të pafavorshme;
- Programet shëndetësore që kanë në mënyrë specifike në objektiv gratë dhe burrat;
- Nisma të posaçme për vajzat;
- Nisma në tregun e punës për gratë;
- Programe riintegrimi për ushtarët meshkuj;
- Nisma për të trajtuar dhunën kundër grave;

I

- Programe mikrokredie për gratë;
- Bursa arsimore për gratë;
- Shpenzimet buxhetore për nxitjen e mundësive të barabarta për punonjësit në shtet;
- Shpenzimet e përgjithshme ose të integruara nga të gjitha ministrinë dhe agjencitë shtetërore.



# Shtetshini

## Buxhetimi i mbështetur në performancë dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në Austri

Legjislacioni i ri dhe një ndryshim kushtetues në vitin 2007 në Austri kanë çelur rrugën për një reformë të gjithanshme të procesit buxhetor, duke ecur drejt një buxhetimi të mbështetur në performancë, i cili synohet të arrihet në vitin 2013. Nga kjo preken të gjitha proceset administruese dhe cikli i buxhetit, duke përfshirë strategjinë afatmesme dhe buxhetin vjetor, hartimin, realizimin dhe kontrollin e buxhetit. Katër rezultatet strategjike të përcaktuara në kushtetutë janë barazia gjinore, transparencja, efikasiteti dhe një paraqitje e vërtetë dhe e drejtë e pozicionit financiar të qeverisë federale të Austrisë. Administrata austriake e konsideron objektivin e caktuar me kushtetutë lidhur me barazinë gjinore si një objektiv që përkon me konceptin e vendosur të buxhetimi gjinor ose buxhetimit që inkorporon barazi gjinore. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor përbën, kështu, instrumentin financiar të politikave për vënien në zbatim të strategjisë së Austrisë për integrimin gjinor.

Tabela e mëposhtme ilustron se si duhen dokumentuar në dokumentet e buxhetit objektivat, duke përfshirë edhe objektivat e barazisë gjinore.

Kontributi në objektiv	Masat kyçe	Çfarë konsiderohet sukses? Piketat/shifrat e ecurisë për n+1	Çfarë konsiderohet sukses? Piketat/shifrat e ecurisë për n
		Të paktën një piketë	Mbartja e piketës/treguesit krahasues nga viti i fundit për arsye krahasimi

Në strukturën e re, buxheti vjetor përbëhet nga tre niveli organizimi të buxhetit: buxhet kapitulli, buxhet global dhe buxhet i hollësishëm. Rezultatet duhen përcaktuar për të gjitha nivelet, ku kërkohet që rezultatet të jenë:

- Aktuale
- Të njëtrajtshme në të gjitha nivelet e buxhetit
- Të kuptueshme
- Të auditueshme

I

- Të krahasueshme
- Të verifikueshme

Duke njohur vështirësitë e lidhura me matjen e rezultateve, Kancelaria ka nxjerrë udhëzues për kufizimin e treguesve të krahasimit që të mos shkojnë përtej një numri të menaxhueshëm dhe për identifikimin e piketave që duhen arritur në rrugën drejt arritjes së rezultateve. Krahas kësaj, udhëzuesi nxit përdorimin e informacionit përshkrues (cilësor) në dokumentet e buxhetit.



# Shteti

## Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në Andaluzi

Baza për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në Andaluzi është një ligj i vitit 2003 për masat fiskale dhe administrative. Ligji ka dy dispozita: e para është kërkesa që buxheti rajonal që i paraqitet parlamentit të përmbajë një raport për efektin gjinor<sup>6</sup> dhe e dyta është ngritja e një komisioni pranë Ministrisë së Financave për të mbikëqyrur realizimin dhe aprovimin e raportit për efektin gjinor.

Një risi e veçantë është sistemi i klasifikimit “G+” për dhënien përparësi atyre programeve buxhetore që janë më aktualë për çuarjen përpara të barazisë gjinore. Përdoren katër kritere për përzgjedhjen e programeve, sipas të cilave programi:

- duhet të ketë aftësi transformuese,
- duhet të ketë ndikim në një shkallë të madhe,
- duhet të ketë kapacitetin për të zvogëluar pabarazinë gjinore dhe
- duhet të lidhet me punësimin në administratën e Rajonit.

Çdo program vlerësohet sikurse tregohet në tabelën e mëposhtme:

Shkalla “G+”

	Ndjeshmëria gjinore	
Aktualiteti	Po	Jo
I ulët	g1 Programet që i prekin njerëzit, me një natyrë në thelb të brendshme ose instrumentale	g1 Programe pa ndikim tek personat dhe me një ndikim të tërthortë të ulët ose joekzistent

<sup>6</sup> Kjo është modeluar në bazë të “Deklaratës së buxhetit të ndjeshëm për çështjet gjinore”, një prej instrumenteve të Sekretariatit të Bashkësisë së Shteteve.

I mesëm

G

Programe me ndikim të ulët, me aftësi të kufizuar transformuese ose me aktualitet funksional të zvogëluar

I lartë

G+

Programe me interes madhor për shkak të kapacitet transformues, ndikimit dhe aktualitetit të njohur funksional

Procesi i vlerësimit me pikë bëhet përmes një procesi me pjesëmarrje ku merret mendimi i të gjitha qendrave administrative për të gjithë zërat buxhetorë së bashku me informacione objektive për grupet e synuara të përdoruesve të shërbimeve, krahas mendimit të qarqeve akademike.

Edhe pse secila agjenci është përgjegjëse për klasifikimin e programeve të veta, këto duhet t'i aprovojë Komisioni për Ndikimin Gjikor (një organ bashkërendues ndërministror). Krahas kësaj, çdo program shqyrtohet çdo vit, meqë me zhvillimin e njohurive prej ekspertit tek stafi, programet që më parë janë perceptuar si me shumë pak ose aspak aktualitet gjikor mund të riklasifikohen si programe me aktualitet gjikor.

Pas klasifikimit, planifikohen objektivat strategjike me veprimet përkatëse, së bashku me treguesit dhe me një sistem vlerësim-monitorimi. Prej fillimit të përdorimit, kjo metodikë është përmirësuar nga viti në vit, me një program të vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë. Në bazë të buxhetimit të përgjigjshëm gjikor është një proces i ndryshimit organizativ përmes të cilit fokusi është tek ndryshimi i vlerave, prioriteteve dhe stereotipave përmes proceseve të reja të mësimi dhe sigurimit të asistencës teknike nga ekspertë.

Raporti për Ndikimin Gjikor i buxhetit të vitit 2010 vë në pah progresin e ndjeshëm të bërë drejt arritjes së objektivit të standardizimit të një sistemi analize brenda operacioneve të përditshme të secilës agjenci. Ndër arritjet e renditura janë:



# Shtetshini

- zvogëlimi i numrit të projekteve të vlerësuara si pa aktualitet gjinor
- rritja e numrit dhe cilësisë së treguesve - 21 më shumë tregues të barazisë gjinore gjatë periudhës 2009-2010
- bërja e një dokumenti udhëzues strategjik për çdo aktivitet buxhetor që do të mbahej dhe përditësohej në lidhje me ecurinë e rezultateve të barazisë gjinore.



## Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në Belgjikë

Sikurse në Austri dhe Andaluzi, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është një kërkesë ligjore në Belgjikë. Ligji i vitit 2007 është miratuar në kuadër të integritimit gjinor. Ai përcakton detyrimin ligjor për të integruar një dimension gjinor në përgatitjen e buxhetit. Ligji jep hollësi për mënyrën me të cilën zhvillohet procesi:

Çdo ministri duhet të fillojë me klasifikimin e të gjithë zërave buxhetorë (në Belgjikë përdoret termi “kredi”) sipas aktualitetit gjinor të tyre:

**Kategoria 1 përbëhet nga zëra buxhetorë që perceptohen se nuk kanë aktualitet gjinor, plus shpenzimet për funksionimin e brendshëm;**

**Kategoria 2 ka të bëjë me veprime konkrete për nxitjen e barazisë mes grave dhe burrave; dhe**

**Kategoria 3, zëra buxhetorë që kanë një dimension të dukshëm gjinor.**

Lidhur me zërat e kategorisë 1 nuk kërkohet asnjë veprim. Por pritet që, me zhvillimin e njohurive prej ekspertit, disa prej zërave do të riklasifikohen si zëra të kategorisë 3 dhe t'i nënshtrohen analizës gjinore.

Për çdo zë të kategorisë 2, duhet përgatitur një “evidencë gjinore”. Kjo është një tabelë e thjeshtë, e cila vepron si një mënyrë e mbajtjes së një llogarie të shpenzimeve për nxitjen e mundësive të barabarta. Evidenca gjinore nga secili departament do të rendiste të gjitha shpenzimet për mundësitë e barabarta në një tabelë. Kjo i bashkëlidhet argumentimit të buxhetit dhe bëhet pjesë e dokumentacionit zyrtar të buxhetit që i paraqitet parlamentit.

Zërat e kategorisë 3 i nënshtrohen një analize të ndjeshmërisë gjinore (e quajtur ndonjëherë si vlerësim i efektit gjinor). Rezultatet e analizës, të cilat ndërthurin një analizë cilësore dhe sasiore, duhen përpiluar në një “koment gjinor”. Komenti gjinor bëhet pjesë e argumentimit buxhetor.



# Shtetshihet

Në Belgjikë, përgatitjen e buxhetit e bën Shërbimi Publik Federal (një agjenci e veçuar nga Ministria e Financave). Shërbimit Publik Federal i është ngarkuar detyra e përgatitjes dhe shpërndarjes së udhëzimeve se si duhet vënë në zbatim buxhetimi i përgjigjshëm gjinor. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor përmendet në qarkoren e rregullt të Shërbimit lidhur me përgatitjen e buxhetit. Krahas kësaj, ka një qarkore të veçantë të hollësishme për proceset që kërkon buxhetimi i përgjigjshëm gjinor.

Drejtorja e buxhetit dhe administrimit në çdo ministri është përgjegjëse për bashkërendimin e punës së menaxherëve të “dosjeve” detyra e të cilëve është të bëjnë analizën për komentimin gjinor dhe të përpilojnë informacionin për relacionin gjinor.

Gjinia është integruar si kategori brenda sistemeve të kontrollit buxhetor. Kjo do të thotë se inspektorët e financave dhe institucioni i auditimit duhet të monitorojnë respektimin e detyrimeve ligjore në lidhje me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Në këtë shembull, ajo që vihet re është sa specifik është legjislacioni kur përcakton se duhet vënë në zbatim buxhetimi i përgjigjshëm gjinor dhe si duhet mbështetur dhe monitoruar nga makineria ekzistuese e shtetit. Krahas kësaj, legjislacioni kërkon që çdo ministri duhet të sigurojë mbledhjen dhe administrimin e të dhënave të zbërthyera sipas gjinisë dhe të vendosë tregues gjinorë aktualë për fushën e kompetencës.





**BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR**  
NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË